

NIKOLLA MULLISI



Tipa të
personisur

85H. 32

M. 98

NIKOLLA MULLISI

TIPA TË PSONISUR

(Tregime humoristike)

20506

SHTETI I SHqipëRIE

TIRANË 1978

~~5337~~

SHTETI I SHqipëRIE BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

TËRKUZË

Shpesh më ka qëlluar të shoh arqitektë duke bërë projekte dhe, atë çast që kam parë mbi teknograf atë objekt të vizatuar bukur, pastër, me atë ambjent që merr ajër lirisht, nuk kam lënë pa shprehur kënaqësinë time. Po projekti siç dihet është fillimi i punës.

Kam para sysh një projekt të një shtëpie kulture. Si zgjidhje m'u duk i përsosur, aq sa nuk isha në gjendje të bëja asnjë vërejtje. Mbi bazën e këtij projekti u hapën themelet dhe pak nga pak ndërtesa hodhi shtat, derisa një ditë erdhi komisioni i kolaudimit për të marrë në dorëzim objektin e përfunduar. Si nuhatën mirë, ata thanë:

— Shokë, këtij objekti i mungon uji i pijshëm. Janë bërë instalimet pa siguruar më parë ujin.

— Duhet të jetë harruar nga projektuesi.

— Sidoqoftë, ne nuk e marrim në dorëzim. Tungjatjeta!

Të nesërmen ndërmarrja komunale filloi punimet për hapjen e kanalit të ujit të pijshëm. Dhe një ditë prej ditësh uji shpërtheu nëpër rubinetat e ndërtesës.

Erdhi përsëri komisioni. Kësaj radhe sugjerime bënë nëpunësit e shtëpisë së kulturës e jo ata të komisionit të kolaudimit.

— Shokë të komisionit, mungon rrjeti telefonik. Kemi vendosur aparate, po s'kemi lidhje.

— Shumë e drejtë. Ja dhe këtu një gabim tjetër i projektuesit, prandaj ne nuk e marrim dot në dorëzim. Mirë u pafshim!

Të nesërmen ata të shtëpisë së kulturës vajtën në PTT dhe qanë hallin. Ata të PTT-s dërguan punëtorët dhe brenda pak ditëve ja filluan zilet e telefonit.

Objekti tani është gati, mungesat janë plotësuar. Tani mbetet vetëm prerja e shiritit. Mbetën akoma njëzet ditë nga dita e inaugurimit. Vijnë përsëri ata të komisionit të kolaudimit dhe, si i hedhin një sy rreth e rrotull objektit, thonë njëzëri:

— Të merremi vesh...

— Unë nuk mund të bëj kompromise. Mirë u pafshim!

Përsëri telefonat:

— Alo! Komunalja?... Ju lutemi ejani hiqni dherat e kanalit që hapët, pasi po afrohet dita e inaugurimit...

— Kini të drejtë, shok, por, me sa më kanë informuar, atje janë hedhur dhe dherat e themeleve të ndërtesës, kështu, në këtë çështje, kanë

gisht dhe ata të ndërmarrjes së ndërtimit. Shkurt, dherat janë përzier në mënyrë që s'dihet se kush është dheu që i takon ta heqë ndërmarrja ime dhe kush ai që duhet ta heqin ndërmarrjet tjera që kanë punuar në këtë objekt.

Ditët kalonin dhe data e inaugurimit afrohej. Problemi i dherave ishte çeshtja kryesore e ditës. Çdo bisedë zyrtare apo private ishte lidhur me dherat.

Për të shuar sherrin erdhën në vendin e ngjarjes përfaqësues të posaçëm nga ndërmarrja e ndërtimeve, ajo e komunales dhe PTT-s.

— Unë, — e mori fjalën përfaqësuesi i ndërtimit, — nuk mund të dërgoj maqinat të heqin dherat pa i hequr më parë të tjerët. Siç dihet, dherat që kemi nxjerrë nga themelet janë në fund fare.

— Edhe unë, — tha ai i komunales, — nuk mund të dërgoj karrocet të heqin dherat pa i hequr më parë këta të PTT-s.


— Si t'i heq dherat unë, more shokë, — u hodh ai i PTT-s, kur ata janë përzier e janë bërë lëmsh? Për veten time, unë nuk e marr dot përsipër një punë të tillë.

— Kur nuk e merr ti, ç'kusur kam unë. . .

Pse ta marr përsipër unë, kur dherat s'më përkasin mua?

— Më lindi një mendim, — tha përfaqësuesi i ndërmarrjes së ndërtimit: — pse nuk e përdorni këtë dhe për të sheshuar oborrin?

— Ose të bëni lulishte, — tha përfaqësuesi i komunales. — Lule ju japim ne.



— Nuk është mendim i keq, — u hodh e tha ai i PTT-s. — Kjo bëhet pa shpenzime, me punë vullnetare.

— More shokë...

— Bëj kështu si të themi ne, pasi do të të bjerë mirë.

— Do të na kërkosh, po do të jetë tepër vonë! Atëhere ne nuk do të të ndihmojmë dot.

— As unë. E ku kam nge unë të merrem me dhera?

— Kështu siç e kemi nisur ne nuk përfundojmë kurrë, — tha përfaqësuesi i PTT-s. — Unë nuk kam kohë, prandaj propozoj t'i japim një afat shokut drejtor që të mendohet për propozimet tona.

— Dakord. Tungjatjeta!

— Prisni, more shokë! — thirri drejtori i shtëpisë së kulturës. S'kam ç'të mendohem. Unë dua të më hiqen dherat dhe pikë.

Kësaj radhe zërin e tij nuk e dëgjoji njeri.

...Dita e inaugurimit po afrohej. U blenë shiriti dhe gërsëra. Po dherat? Si mund të bëhej inaugurimi i një objekti të rëndësishëm pa hequr dherat? Mbledhjet njëpalëshe, dypalëshe, tripalëshe dhe katërpalëshe nuk dhanë rezultate. Duhej gjetur patjetër rrugëdalja dhe, me iniciativën e drejtorisë u organizua një mbledhje pesëpalëshe.

Secili në këtë mbledhje shprehu pikëpamjet dhe arësytimet e veta, por, meqë secili mbronte «interesat» e ndërmarrjes së tij, tërë këto debate nuk patën bërëqet. Meqë disa kishin prerë bileta për në teatër, u propozua që diskutimet të mbylleshin me aq dhe seanca tjetër të vazhdonte të nesërmen.

Kur zbritën shkallët dhe dolën në oborr, të gjithë mbetën gojëhapur: dherat ishin hequr.

— Më bëjnë sytë, apo qysh? — pyeti njëri prej tyre.

— Kush i hoqi dherat? — pyeti rojen drejtori i shtëpisë së kulturës.

— Punëtorët, shoku drejtor.

ANALFABETËT

Marjana, megjithëse nuk është e vetme në shtëpinë e Koçillarëve, përsëri duket shumë e përkëdhelur. Kur nuk ja plotëson kapriçot, ajo shtrihet në dysheme, përplas këmbët dhe bërtet me të madhe. Prindërit, që t'u bien veshët rehat, ja plotësojnë dëshirën dhe e nxjerrin jashtë. Marjana luan pak aty nëpër shkallët e apartamentit dhe pastaj mërzhitet e kthehet përsëri në shtëpi.

— Pse nuk luan akoma? — i thërret e ëma.
— Apo do të na nxjerrësh veshët përsëri.

— Do të rri urtë, — premton Marjana dhe nis të luajë me lojrat e saj dhe me ato që ka trashëguar nga e motra, por të cilat janë të shkatërruara të gjitha. Kukllat janë pa duar e pa këmbë, maqinat pa rrota, kurse maceve prej llastiku, që dikur bënin fiu-fiu, nuk u gjendet as nam as nishan.

Heshtja e Marjanës e bëri njërin nga bashkëshortët të mërzhitet e të thotë me ngadalë, që të mos e dëgjojë çupa, e cila tani ka gjetur karar:

— A nuk bëjmë një shetitje?

— Me gjithë qejf, — përgjegjet tjetri dhe fillojnë e vishen.

Marjana e pikas dhe pyet:

— Ku po shkoni, mami?

— Te doktori, të keqen mami. Ti s'bën të vish se ai të bën gjilpërë.

— Rri me Luljetën, — i thotë i jati, — se kur të kthehem do të të sjell koko.

Marjana vazhdon të luajë por pastaj, pasi mërzitet, me lejen e motrës së saj Luljetës, e cila nuk është veçse nja dy vjet më e madhe, kërkon të dalë jashtë në korridor. Kësaj radhe i është shkrepur të bëjë një lodër të re, atë që shpeshherë e bën në shtëpi nëpër fletore të vjetra, ose nëpër copa letrash. Merr një stol, një copë thengjill, del në korridor dhe fillon e qëndis mamin e një shoqes së vet fqinje, e cila e ka inat se i bërtet sa herë e shikon të shtrirë në dysheme. I bën kokën, trupin, këmbët, por duart nuk i mban mend ku i ka, ndaj heq dy vija në majë të kokës të cilat duken si antena.

Atëherë shoqja e saj fqinje, kur merr vesh këtë fyhet dhe, për t'u hakmarrur, vizaton me gozhdë, që të mbetet përgjithnjë të jatin e Marjanës. Marjana qan nga inati dhe s'di si të hakmerret. Luljeta, e cila posa ka filluar të shkruajë e të lexojë, shkruan me laps të kuq në vendin ngjitur me portën e shoqes fqinje një fjalë të pahijshme. Djali i madh i fqinjës, kur e lexon atë fjalë, ndizet dhe nga inati godet me top të lagur murin dhe tavanin e korridorit rrotull portës së Marjanës. Brenda një ore, sa vazhdon «vizita mjekësore» e prindërve të Marjanës, muri dhe tavani i korri-

doreve të porsalyer nga ata të pasurisë së shtetit
kthehet në një ekspozitë me figura moderniste.
Kjo ngjall kureshtjen e banorëve të asaj shkalle e,
pa tjetër, edhe të prindërve të Marjanës, të cilët
kur u kthyen shfaqën mendimin e vet për talentin
e fëmijës së tyre.



— Kush e ka zhgarravitur kështu? — pyet dikush me një zë të trashë tufën e fëmijve, që po bënin sehir vizatimet në ato faqe muri.

— Ku dimë ne, thonë ata dhe largohen të tromaksur, porsa marrin vesh se ai është kontrollori.

— I kujt je ti? — pyet kontrollori një fëmijë, të cilin e ka mbërthyer nga të dy veshët.

— Nuk e kam shtëpinë këtu unë, — gjegjet fëmija, me zemrën që i rreh si e zogut.

— Ashtu, ë... — dhe e lëshon.

— Të gënjen, shoko! — u dëgjua zëri i një fëmije tjetër.

Kontrollori tund kokën dhe kërkon ta kapë përsëri. Hyn në korridor dhe troket në derën e parë të katit të parë. Askush s'i përgjegjet. Troket në të dytën, në të tretën, ngjitet lart po askush nuk përgjegjet.

— Duhet të jenë në punë, — mendon kontrollori dhe largohet. Por mendja i rreh tek korridori dhe shkallët e atij pallati, që janë bërë për faqe të zezë dhe trillon lloj-lloj planesh për të kapur fajtorin. Kthehet përsëri te pallati, por kësaj radhe fshehurazi dhe në atë orë që ishin kthyer prindërit e fëmijëve nga puna. Fëmijët e pikasin dhe shpërndahen. Ai sulet në tufë dhe mbërthen njërin prej tyre.

— Kush e ka zhgarravitur murin?

— Ja, ajo vajza atje.

Marjana u fut menjëherë brenda dhe mbylli derën. Kontrollori ngjiti shkallët dhe trokiti mu te porta ku u fut Marjana.

— Ç'urdhëroni? — pyet e ëma e Marjanës.

— Vajza juaj ka shkruajtur nëpër muret e korridorit.

— Vajza ime! — Ç'ne, ajo akoma s'di as të shkruajë, as të lexojë.

— Emrin, ju lutem, — dhe nxori bllokun e gjobave, e mbështeti në gjunjë dhe u bë gati të shkruante.

— Ju lutem, emrin dhe mbiemrin, përsëriti kontrollori pa ngritur sytë.

— Më falni, vajza ime...

— Ju lutem, emrin.

— Ç'është, — ndërhyri babai i Marjanës.

— Do t'ju gjobis, — sokëlliu kontrollori.

— Dale, ta marrim shtruar. Vajza ime s'di as të shkruajë, as të lexojë, as të pikturojë. Vajza ime...

— Kush atëherë e ka bërë murin në atë ditë? — u zbut kontrollori,

— Ndofta fëmijët e fqinjës, që janë më të rritur.

Kontrollori mbyll bllokun dhe sulet në portën tjetër.

— Ç'urdhëroni — i përgjigjet një plakë e fishkur dhe e paktë.

— Kush ka shkruajtur në mure?

— Ku di unë e shkreta të shkruaj! — gjegji plaka. — Se mos kemi bërë shkollë ne plakat.

— Mojt fëmijët e tu kanë shkruajtur nëpër mure.

— S'kemi fëmijë të vegjël ne, trokit në portën tjetër.

Kontrollori, i tërbuar nga inati, troket në derën që i thotë plaka.

— Ç'ne djali tonë, — përgjegjet e nevrikosur një grua me robdëshambër dhe me flokë të shpu-

purishura, si të ish ngritur atë kohë nga gjumi.
— Fëmija ynë nuk di as të shkruajë as të lexojë.

— Do me thënë tërë fëmijët tuaj s'dinë të shkruajnë e të lexojnë.

— Si urdhëron, s'dinë.

Kontrollori fut bllokun e gjobave në xhep dhe zbret shkallët i pakënaqur. Duke u hedhur një sy hieroglifeve në mure tha me vete: — «Interesant, a thua që në këtë shkallë vetëm fëmijët të jenë analfabetë?»...

DJALIN S'E BËJ MARANGOZ

Më në fund edhe e shoqja e Tasit, pas dy vajzave, lindi djalë. Fitore e madhe në fushën e gjenealogjisë, gëzim i parrëfyer për familjen e Tasit, hare e madhe për dy vajzat e vogla që u bënë me vëlla.

Hareja shpërtheu dyert, dritaret dhe pushtoi bashkë me shtëpinë edhe zemrat e atyre që prisnin një djalë prej Tasit. Edhe pse po mbushet një vit qëkurse lindi fëmija, hareja s'është larguar nga praku i derës, por ka qëndruar gjithmonë si barut i thatë, gati të shpërthejë kurdoherë që ta lypë nevoja.

Oj, medet! Burrë e grua janë hutuar dhe s'mbajnë mend vitin e djalit, por këtë ua kujtojnë ata që janë specializuar dhe merren me punët e botës.

Tezja u thotë:

- Do të bëni darkë për motin e djalit!
- Ashtu!..
- Ashtu, po, e do zakoni,

— Po ne s'kemi bërë ndonjëherë.

— Kini lindur vajza, prandaj, kurse tani për djalin... Është djalë...

Burrë e grua, të alarmuar, nisin nga pregatitjet, bëjnë llogari në përputhje me buxhetin e tyre, bëjnë plane, marrin vendime...

Dhe llogaritjet bëhen me aq përpikmëri, sa për një çast pandeh se këta njerëz duan të nisin ndonjë raketë për në hënë.

Në krye të listës së të ftuarve figuroj unë, megjithëse ka më të afër në gjini. Nuk di përse, por, ndoshta, tezja ka patur parasysh se unë ja them kalemit më shumë se të tjerët, të cilët janë njerëz të thjeshtë.

Të prirë nga tezja, futemi në dhomën ku është pregatitur ceremonia e rastit. Ajo nuk harron të hedhë këmbën e djathtë përpara. Kështu bëjmë dhe ne pas saj. Ajo ka kujdes të mos bëjë ndonjë gabim dhe ja ngul sytë ndonjërit prej nesh që harron të bëjë si ajo.

Në dhomë zëmë vend nëpër karrige të cilat janë vendosur në formë patkoi. Përpara nesh, mu në mes të dhomës, ndodhej një kuti e madhe me lloj-lloj veglash për të luajtur fëmijët.

I jati heq sahatin nga dora dhe e ve në kuti për të shtuar lodrat. Tezja e rrëmben me vrull dhe ja kthen duke e qortuar:

— Nuk e bëj djalin unë sahatçi...

Ajo heq nga kutia disa lodra që i duken të papërshtatshme dhe vendos ca të tjera më të nevojshme. Ne vështrojmë dhe mbajmë të qeshurit.

Foshnja është ulur përbri kutisë dhe e humbet mendjen tek ne, që i themi: «Kape xhan, kape!»

Ai vështron të jëmën që i tregon me gisht kutinë, hap gojën i habitur dhe pastaj ja plas të qarit. Ndërkohë ndërhyt tezja dhe vendos rregullin e qetësinë. Tani nuk themi më ne kape, por vetëm tezja. Ajo drejton ceremoninë. Ne nuk qeshim, as nuk bëjmë shaka me tezen, sepse fëmija, siç duket, preket shpejt dhe qan...

— Kape, xhan i babit!...

— Kape, xhan i mamit!...

— Kape, xhan i tetës!...

Fëmija shikon me sy të përbotur kutinë, shtrin dorën me pahir dhe na vështron ne që ja kemi qepur sytë. Ai e heq dorën e tij si t'i jetë djegur nga prushi, por kësaj radhe qesh dhe na zbulon ato dy kicat e vogla që i kanë dalë në nofullën e poshtme e që duken si dy kokrra orizi.

— Kape, t'u bëfsha, lolo! — thotë përsëri tezja dhe i dikton me gisht lodrat.

Fëmija për një çast duket sikur merr guxim, shtrin dorën përpara, kap një sharrë të vogël, e ngre përpjetë me sa fuqi ka dhe e tërheq nga vetja. Lodrat rrokullisen e, bashkë me to, edhe të gajaturat tona.


Ne bërtasim njëzëri:

— Do t'u bëka marangoz!

Fëmija trëmbet përsëri, lë sharrën dhe hidhet në krahët e së jëmës.

Tezja shfryn:

— U, na marrtë të keqen! Pse, marangoz do ta bëjmë djalin ne!.. Virini, moj, djalit të kapë kalemin, të bëhet doktor, inxhinier, gjykatës!.. — u thotë prindërve dhe zbraz lodrat mbi qilim, duke e



hequr sharrën. Ajo i dikton përsëri me gisht fëmijës lodrat dhe i thotë me gjuhën e saj:

— Kap, të kegen teta!..

Fëmija vë kujen dhe shtrin doçkat drejt sharrës

— Do sharrën — themi ne, — do të bëhet marangoz... .

Tezja mundohet ta fshehë nëpër kanape dhe, kur e sheh se fëmija qan akoma, ajo lëviz krahët dhe bën si qen, ham, ham, ham... .

— Jepja! — i lutemi tezes.

Ajo vërshëllen mbi ne si lokomotivë:

— Nuk e bëjmë djalin marangoz, shtëpia jonë nuk e ka zanat marangozllëkun, ne kemi qenë den baba den... — këtu ajo u përtyp, pasi nuk thoshte dot se gjyshi i tyre kishte qenë teneqexhi dhe, vazhdon akoma më me forcë: — Djali ynë do të bëhet doktor, ju bëftë tezja, doktor!.. Nuk e shihni

tërë këtë ballë, duket nga balli, — dhe ja ngre me dorë ato pak flokë për të na treguar ballin e tij.

Fëmija çirret akoma, ndoshta sepse nuk është dakord me këto që thotë tezja, ndërsa e ëma e tund në krah fëmijën, mundohet ta pushojë, që të mos kërkojë sharrën.

Tezja, e cila është direku i kësaj ceremonie, e humb pusullën dhe prindët duken mjaft të shqetësuar. Pse, shaka i thonë që djali i tyre të bëhet marangoz!..

Edhe ne e humbëm pusullën. Shikojmë shoku-shokun me sy, më në fund vendosim të ikim.

Kur po dilnim te porta, dëgjonim tezen që thoshte nëpër shtëpi:

— Mos qaj, t'u bëftë tezja, s'të bëjmë marangoz sikur qameti të bëhet, ty do të të bëjmë doktor!..

Dhe megjithëse ne kishim kaluar prakun e portës, akoma dëgjoheshin lutjet e tezes:

— Mos qaj, doktor i tezes, mos qaj, se tezja s'të bën kurrë marangoz... .


M I Z A

Bar-bufesë «Përparimi» ju ndërrua banaku, i dhanë një dorë bojë vaji, i vunë perde basmaje xhamave, i ndërruan karriget dhe tavolinat, i bënë një tabelë tjetër me shkronja të mëdha, dhe kaloi nga kategoria e dytë në të parën. Vetëm personelin shërbyes nuk «e zuri burokracia».

Ne interesohemi tani për klientin tonë, i cili vjen pas tërë këtyre ndryshimeve, shkel si në majë të gishtërinjve për të mos u prishur muhabetin klientëve të tjerë që bisedojnë me zë të lartë, shpërndan tymin e dendur të duhanit dhe ulet në një nga tavolinat me syprinë prej xhami. Vjen akoma era bojë vaji. Klienti i hedh një sy lokalit si për të parë ndryshimet që janë bërë dhe pastaj troket në tavolinë me rrethin e unazës. Në vend të kamerierit vjen me të shpejtë një mizë dhe si e mallëngjyer pa masë e «puth» klientin tonë në ballë, në faqe dhe pastaj në majë të hundës. Klientit i vjen bezdi dhe, pasi ja bie në majë të hundës, e zë me një lëvizje të shkathët të dorës. Klienti më në

fund vendos t'ja falë jetën, por me kusht që ajo mos ta mërzisë më. Ai hap grushtin dhe miza bën një «salto mortale» dhe bie mbi syprinën e xhamit të tavolinës pa u vrarë fare. Ajo bën disa gjes-te si ata konferencierët që deklamojnë programin e ndonjë shfaqjeje. Pastaj si fërkon një copë herë duart dhe krahët, shket mbi xhamin e tavolinës si patinatore e shkëlqyer dhe ngrihet në ajër. Klienti i ndjek këto manovra, megjithëse bëhen në një të dhjetën e sekondës. Miza bën në ajër disa fluturime të guximshme që, për nder, as piloti më i talentuar nuk do t'i arrinte kurrën e kurrës. Pasi silltet me shpejtësi të jashtëzakonshme rreth let-rës për miza që ka mbetur e varur nga koha kur lokali ishte i kategorisë së dytë, ulet në pistën e kristaltë të tavolinës. Bën disa hapa tëhu, përshëndet klientin me kokë, fërkon duart me një farë krenarie që të lë përshtypjen sikur thotë: «Kjo s'është gjë fare, të shohësh tani çfarë mrekullirash do të bëj». Dhe, me të mbaruar këtë ligjëratë të shkurtër plot madhështi, rrëshqet mbi pistë dhe sa çel e mbyll sytë gjindet lart në tavan. Klienti ngre sytë lart dhe sheh se kësaj radhe miza fluturon bashkë me një shoqe të saj. Ato të dyja të zëna dorë për dorë fillojnë të ekzekutojnë një numër të mrekullueshëm akrobatik, që klientin tonë e lë gojëhapur. Ai mbetet i mahni-tur. Nuk është hera e parë që sheh mizë, po ja që kësaj radhe një forcë e padukshme ja mpin mendjen dhe e topit si asnjëherë tjetër. «Çudi, — thotë klienti me vete, — si nuk e paskam vënë re këtë aftësi dhe talent të mbrekullueshëm të mizës?!»

Ndërkohë, kamerierja e ish-lokalit të katego-



risë së dytë i sjell kafënë dhe gotën e ujit. Klienti nuk e vë re buzëqeshjen e kategorisë së parë të kamerieres, pasi është përqëndruar në vallen që hedhin mizat atje lart në tavan. Ai, duke admiruar akrobacirat e shkëlqyera të këtyre dy mizave, vëren se këto insekte nuk qenqeshin fare të padobishme. Përkundrazi! Çdo qenje e gjallë ka anën e vet të panjohur, e cila, kur arrin të zbulohet nga njerëzimi, vihet në shërbim të tij. Ma-

rrim për shembull këta të lokalit «Përparimi»; kanë arrirë që, duke shfrytëzuar cilësitë e rralla që ka miza, të organizojnë numra të bukur akrobatikë, për të kënaqur dhe argëtuar sa më shumë klientët e tyre. Ndaj dhe çmimet në këtë lokal janë pakëz të kripura.

Duke menduar kështu, klientit tonë i vete mendja te pogromet, te aksionet që organizohen nëpër lagje e fshatra për të vrrarë mizat, dhe i vjen çudi se si dhe ai vetë ka marrë pjesë në këto aksione. «Jam i bindur, — thotë ai, — se, po të njohin njerëzit cilësitë dhe talentin e saj të mrekullueshëm në lëmin e fluturimit, ashtu siç i njohin ata të lokalit «Përparimi», nuk do të ndërmerrenin kurrë të këtilla aksione barbare, por do t'i linin të shkretat rehat në punën e tyre. Unë për veten time, — përfundon ai, — nuk do të vë dorë në to». Atij i vjen keq kur kujton se pak më parë desh e mbyti atë që e puthi mu në majë të hundës. Për këtë faj, po të ishte miza një qenje njerëzore, do të ishte gati t'i binte ndër këmbë dhe t'i kërkonte të falur, po s'ka kohë të bëjë asnjërin as tjetrën, sepse mu përpara syve të tij ndodh katastrofa ajrore më e tmerrshme që i kanë parë sytë në jetën e tij. Të dyja mizat përplasen dhe bien në filxhanin e kafesë, që nxjerr akoma avull.

Klienti i sheh tek përpëliten në filxhanin e kafesë dhe, për çudi, në vend që t'i vijë keq, i vjen ndot dhe shfryn tërë inat: «Tfu, ju marrtë dreqi!» Ai ngrihet pa pirë kafen dhe ikën duke mallëkuar sojin e sorollopën e tyre, si edhe personelin e bar-bufesë që nuk u bë dot, sikurse lokali, i kategorisë së parë.

BRAHUSHI, BILUSHI DHE LOPA

Brahushi, në inventarin e shtëpisë së tij, përveç gruas dhe tre fëmijve, numëronte edhe dy lopë, njëzet bagëti të imta dhe 15 krerë shpendë. Në tërë këtë tufë, Brahushi donte më shumë lopët. Dhe kjo kishte arësyet e saj. Ato ishin të racës dhe jepnin, të paktën, 20 kilogram qumësht në ditë. Veç kësaj, ai merrte rregullisht prej tyre dy viça në vit, të cilët, pasi i rriste, i shiste me hesap. Kështu që Brahushi nuk zinte shat e bel me dorë. Sa për bagëtitë e imta dhe shpendët, megjithëse edhe ato jepnin kontributin e tyre, përsëri nuk merakosej aq shumë, meqë fruti i tyre, qumshti, mishi, leshi dhe vezët shkonin drejtpërdrejt në buxhetin e familjes dhe jo në atë personal. Kjo ishte edhe arsyeja që për këto përkujdesej e shoqja.

Brahushi vetë, mëngjez për mëngjez, pasi mbushte teneqenë me qumësht dhe e pagëzonte me ndonjë litër ujë, nisej për në baxho. Që andej kthehej te klubi i fshatit. Atje, si frekuen-

tuesi më i rregullt i tij, ja shtronte gjer në drekë.

Kështu kalonin ditët, javët dhe muajt. Mirëpo një ditë na u mblodh i tërë fshati dhe, pasi diskutoi punën e kopshteve dhe bagëtive personale, vendosi që këto të pakësohen gjysmë për gjysmë. Kjo për Brahushin që rrufe në qiell të hapur. Ai u turbullua aq shumë, saqë atë ditë për herë të parë mungoi në klub pa arësye. Kur u kthye në shtëpi, i tha së shoqes:

— Si t'ja bëjmë?

— Si të bëjnë të gjithë, — ja preu ajo.

— Bota le të bëjnë ç'të duan. Unë të pyes në di ndonjë marifet, që të mos dorëzojmë të paktën lopën që kemi tepër.

E shoqja ngriti supet dhe nuk i dha përgjegje; bile, ajo e pa si vëngër, si të donte t'i thoshte: «Akoma ndryshe nga fshati ti?». Por Brahushi nuk kishte nge të shihte fytyrën e gruas. Ai ngjeshi opinga dhe u ul poshtë në haur. I erdhi një herë rrotull bagëtive si të donte të konsultohej me to dhe, pasi u dha një dorë jonxhë jashtë racionit, u ngjit përsëri në dhomën e tij.

— I dhashë karar, — i tha ai së shoqes. — Vendosa që një pjesë të bagëtive të imta t'ja shes kooperativës dhe pjesën tjetër ta shes në pazar, kurse lopën do t'ja jap një mikut tim që nuk ka fare. Ai le ta mbajë, ta ushqejë, ndërsa qumshutin ta ndajmë bashkë.

— Pse t'i hymë tërë këtyre telasheve, — u hodh e tha e shoqja, që po e priste më këmbë vendimin e të shoqit.

— S'ka fare telashe. Unë do të hap fjalë se ja

shita lopën filanit dhe asnjëri nuk do të çajë kokën për më tutje.

— Dëgjomë edhe mua, o burrë, — e mori fjalën e shoqja. Por Brahushi nuk priti mendimin e saj. Ai rrëmbeu festën dhe u nis për tek miku i tij, Bilushi.

Kur u kthye prej andej, i tha së shoqes:

— Puna u rregullua si jo më mirë.

Tërë këto punë zgjatën dy ditë, pastaj çdo gjë u qetësua, me përjashtim të shpirtit të tij, i cili akoma përpëlitej në mes dallgësh të mëdha.

Ditën e tretë, pasi vuri në rregull tërë punët e tij, ai shkoi tek Bilushi të merrte vesh si ishte gdhirë lopa e tij e shtrenjtë.

Atje gjeti të shoqen e Bilushit dhe e pyeti:

— Ç'u bë Bilushi?

— Ah, lere ç'na gjeti me lopën tënde, — i tha ajo. — Se kush na ka hapur haurin dhe na e ka marrë lopën!

— Vërtet moj! Po qysh?

— Ka vajtur Bilushi në kryesi të kooperativës t'u thotë atyre për gjëmën që na gjeti.

Brahushi nuk e bëri të gjatë; u nis nxitimthi për nga zyrat e kryesisë së kooperativës. Por s'u mundua shumë, se Bilushi po kthehej me lopën.

— Si është puna? — pyeti Brahushi.

— Lere, mos pyet, — ja ktheu Bilushi me inat. — Ma kanë sjellë në majë të hundës. Në darkë, që thua ti, i dhashë të hante, të pinte dhe, pasi u sigurova se ja kisha bërë gjithë hyzmetin, rashë të flija. Kur në mëngjez më tundi për krahu grua-ja: «Bilush, Bilush ore?» «Ç'ke moj», i them unë përgjumësh? «Çohu se na ka ikur lopa». «Ku ka

ikur moj?» «Ku di unë», më tha ajo e varfëra. Kur u ngrita e gjeta derën e haurit të hapur. «Bo, bo, do të na e kenë vjedhur. Le po kush e dëgjon Brahu-shin» i thashë. U ngrita shpejt, që thua ti, dhe vajta në zyrat e kooperativës që t'u thoja se ç'më kishte ndodhur. Kur kalova andej nga stallat, e pashë këtë bukuroshe mu në mes të tufës së bagë-tive të kooperativës. Që thua ti, mezi e kapa dhe, ja, tani, siç më sheh, po e sjell në shtëpi, që e sjellça...

«Ntëc, ntëc, ntëc», përplasi gjuhën Brahusi.

Të dy miqtë u kthyen në shtëpi bashkë me lopën, që e tërhiqnin për brirësh.

Atë mbrëmje Bilushi, pasi e siguroi mirë derën dhe kyçin ja dha së shoqes, e cila ngrihej më herët se ai, ra të flinte.

Të nesërmen po ai avaz.

Bilushi shkoi përsëri drejt e te stallat e bagë-tive të kooperativës. Lopën e gjeti duke ngrënë bashkë me të tjerat. I xhindosur, i këputi nja dy shqelma vitheve, e lidhi me brez nga brirët dhe u nis për në shtëpi, pa çarë kokën se çfarë i thoshte përgjegjësi i stallës.

«Kjo është për t'u çuditur, — tha me vete Bilushi, — kam një orë që po vras mendjen e nuk po i bie më të se si mund të hapet dera nga brenda. Dale, pa ja ujdin unë kësaj mistreceje, i vë një kyçenicë tjetër dhe çelësat i mbaj vetë».

Kësaj radhe Bilushi, veç masave të zakonshme, i lidhi edhe këmbët lopës, ndërsa çelësin e haurit e vuri nën jastëk.

Të nesërmen e shoqja e Bilushit nuk u ngrit

herët. Kur Bilushi hapi sytë dhe e pa pranë, e shtyti.

— Çohu moj, se erdhi dreka! Pa shko shiko në haur, — i shfryu, ndërsa shtrëngonte çelësat nën jastëk.

— Bilush, çohu, se përsëri lopa paska ikur, — bërtiti e shoqja, pa zbritur akoma në haur.

— Si, moj, ka ikur?.. Po kjo është pikë e zezë! — Ulëriti Bilushi.

U ngrit me të shpejtë, dhe, pasi rrëmbeu një hu të mirë në gardhin e oborrit, u sul drejt stallave të kooperativës, duke murmuritur:

— U mësove keq zotrote në stallat e kooperativës. Dale, pa ta rregulloj unë samarin ty. — Me t'u larguar Bilushi, ja mbërriti Brahushi. Kur mësoi se kishte ikur përsëri lopa, u tërbua nga inati, bile u betua edhe një herë se në mbrëmje do të flinte vetë në haur, paçka se do ta hanin pleshtat. Pas këtij betimi solemn u nis edhe ai nga stallat e kooperativës.

Bilushin e gjeti mbytur në djersë duke ndjekur lopën, e cila nuk dorëzohej kollaj.

— Pse s'e ndihmoni një çikë, — ju hakërrua ai përgjegjësit të stallës dhe çobanit, që rrinin e bënë sehir Bilushin.

— Ne i themi ta lerë këtu bashkë me tufën e bagëtive të kooperativës, — ju kthye përgjegjësi i stallës dhe shtoi duke mbajtur gazin:

— Asaj vetë i pëlqen të rrijë me shoqe.

— Na...! — thërriti Brahushi dhe i tregoi bërrylin.

— S'të pyet kush ty, ju kthye përgjegjësi i stallës, lopa s'është më e jotja. Ti ja ke shitur Bilushit.

— E kam mik, — gjegji Brahushi i zënë gafil.
— Edhe ne e kemi mik e bashkëfshatar, — ja priti përsëri përgjegjësi i stallës. Pastaj ju drejtua Bilushit.

— Hë, si thua, do ta lesh?

— Ç'të le, jeni në vete ju? — S'ju durua prapë Brahushit.

— Të thashë edhe një herë, — ja pat përgjegjësi i stallës, — me ty s'kemi punë.

— Mirë, le të flasë i zoti i mallit, — tha Brahushi i zënë ngushtë.

Te stallat u dukën e shoqja e Brahushit dhe ajo e Bilushit.

— Hë, si thua, — vijonte përgjegjësi i stallës. — Kooperativa do ta blejë aq, sa ja bleve Brahushit. Pastaj, o derëbardhë, qumshtin e lopëve personale po ne dhe fëmijët tanë do ta hamë.

Brahushi nuk priti përfundimin e ligjëratës së përgjegjësit të stallës, po u turr ta zerë lopën



që ishte qasur fare pranë. Po ajo sapo diktoi lëvizjen e Brahushit, ja dha vrapit. Brahushi dhe Bilushi iu turrën pas. Brodhën një copë herë, u mbytën përsëri në djersë e mëgjihatë lopën nuk e zunë dot. Atëherë, të lodhur, të raskapitur, u kthyen tek të tjerët. Kur arritën te stalla, Bilushi bërtiti aq, sa ta dëgjonte përgjegjësi i stallës:

— Bëni ç'të doni me gjithë lopë, unë s'kam nge më të bredh pas saj. Mirëupafshim!

Dhe, ndërsa e shoqja e Brahushit i thosh gruas së Bilushit: «Faleminderit moj motër; që më ndihmove». Brahushi ishte aq i telekosur sa, po të kishte makar edhe një çikë fuqi, do të thërriste: «Në djall vaftë lopa me gjithë Bilush!»

SI MA HODHËN SHOFRËT

Unë, që thoni ju, jam agronom në kooperativën bujqësore të katundit X. . . që prej tre vjetësh. Punën time prej agronomi e kam marrë me shumë qejf. Nuk jua them për mburrje, por, me të zbardhur drita deri natën vonë mua më ke si «xholi» në çdo vend që punohet e deri në kovaçanë ku meremetohen dhe rregullohen veglat bujqësore. Veçanërisht merakun më të madh ja kisha kushtuar një ngastre prej 5 dynymësh të mbjellë me pambuk; dhe këtë pikërisht sepse ishte caktuar si bazë eksperimentale nën kujdesin tim.

Një mëngjez, tek shihja si ngaherë zhvillimin e bimës së pambukut, u ndodha para një të papriture: bimën e kishte zënë sëmundja; ishte një lloj parazit i kuq, si i murmë i përhapur në tërë bimën. Nuk di si t'jua shpjegoj se si u bëra, vura duart në kokë dhe psherëtiva thellë për këtë dhembje që ndjeva.

Duke vërejtur me kujdes bimët e infektuara nga ky parazit i kuq, vrisja mendjen se çfarë sëmundje do të qe kjo. Solla ndër mend tërë së-

mundjet që zë pambuku, por ky lloj paraziti që kishte mbërthyer tërë bimën nuk po më kujtohej fare. Kështu numërova me radhë tërë sëmundjet me tërë karakteristikat e tyre, po këtë lloj sëmundje nuk po e kujtoja fare.


Meqë nuk nxora ndonjë përfundim, nxitova në kryesinë e kooperativës për ta denoncuar këtë sëmundje dhe për të marrë masat e nevojshme. Kryetari në fillim u turbullua më keq se unë, pastaj vendosi të thërriste mbledhjen e kryesisë si dhe të kooperativistëve të tjerë që kishin haber nga kultura e pambukut. Diskutimet zgjatën me orë të tëra dhe bima qarkulloi dorë në dorë, por asnjë nuk i ra në të. Që të mos e zgjatim, mbledhja vendosi që këtij paraziti t'i bëhej një analizë laboratorike në laboratorin kryesor të qytetit dhe për këtë më ngarkuan përsëri mua.

...Për çudi analizat laboratorike nuk nxorën gjë në dritë. Ato konstatuan se bima ishte mbushur me organizma të vdekura, të cilat nuk kishin luajtur asnjë rol mbi bimën.

Meqë nuk u binda nga ky rezultat i papritur, ju luta të bëhej edhe një analizë tjetër më e hollësishme.

Ndërkohë u ktheva në fshat pa pritur përfundimin e analizës së dytë dhe, si i tregova mendimin tim kryetarit të kooperativës, vendosëm që bimën ta spërkatnim me solucion, para se sëmundja të përhapej në të gjithë parcelën. Të nesërmen me t'u ngritur në mëngjez herët, vajta në ngastrën e pambukut. Atje gjeta dy kooperativistë dhe brigadierin që po përgatitnin pompat me solucion. Koha ishte e mirë, por frynte erë e ftohtë. Disa re të bardha nxitonin nga perëndimi

dhe kjo jepte shpresë se moti do të mbante të paktën disa ditë, sa të mbaronte spërkatja. Duke bërë këto hesape, më tërhoqi vëmendjen zhurma e disa kamionave që kalonin me shpejtësi mbi xhadenë e asfaltar në fund të arës së mbjellë me pambuk.



Ç'të shoh. ! Nga të çarat e karrocerisë së këtyre kamionave derdhej përtokë një pluhur i imtë dhe i kuq tamam si piper, të cilin era e shpërndante në të katër anët. Ky lloj paraziti i kuq, që s'ishte tjetër veçse pluhur hekur-nikeli, m'u duk sikur më mbërtheu në fyt dhe u bëra spec në fytyrë, ca nga turpi dhe ca nga inati për këtë gafë të madhe që kisha bërë. Ma hodhën kësaj radhe shoferët, thashë me vete, më turpëruan zyrtarisht. Një gjë më ngushëllon: nuk jam as i pari as i fundit që ma hodhën shoferët. Në qoftë se nuk ju mbushet mendja, pyetni ata të kontrollit rrugor.

Z J A R R I


Megjithëse ngjarja ndodhi atëhere kur unë bëja gjumin e parë, përsëri ju siguroj se ajo që do t'ju tregoj më poshtë nuk është ëndërr po realitet.

Bëja një gjumë të thellë, siç bëhet zakonisht pas ndonjë pune të rëndë fizike apo mendore. Nuk pashë as ëndërra si zakonisht, apo ndoshta pashë po s'mbaj mend asgjë. Vetëm mbaj mend se u zgjova i lebetitur nga një shungullim që mund të krahasohet me një tërmet prej nëntë ballësh.

— Ç'është? — bërtita me aq fuqi sa i zgjova të tërë nga gjumi.

— Zjarr! — ma priti plaka, e cila mënt po më shkulte derën.

U veshja shpejt e shpejt dhe menjëherë u gje-nda në kuzhinë. Që andej shihja një gjuhë flake që dilte nga çatia dhe zhdukej në qiellin e errët. E mora me mend se zjarri kishte rënë në shtëpinë përdhese që gjindet pranë pallatit tonë. Fillova të dridhem nga të ftohtët. Plaka më hodhi shallin e



saj krahëve dhe më shtrëngoi të mbathja çorapet. Flaka që ndriçonte kuzhinën kishte marrë qiejt. Ndërkohë dëgjova tri të shtëna pushke, pastaj erdh e u bë një zhurmë e një potere që s'e merrte vesh i pari të dytin.

Zbrita me të shpejtë poshtë dhe, pasi largova me bërryl disa që kishin zënë rrugën, u ngjita si mace në ca shkallë mbi çati. Pas meje u ngjitën dhe dy të tjerë. U vërsulën nga vendi ku flaka ishte më e madhe dhe zjarri kishte rrezik të përhapet.

Nga poshtë na thërrisnin me të madhe:

— Ruhuni, djema!

— Nxirrni njerëzit! — bërtisja unë nga çatia, kur shihja se sehixhinjtë nxirrnin nga shtëpia vetëm plaçka, bile vetëm çarçafë e batanie.

Ndërkohë çatisën zjarrfikësit dhe ju përveshën menjëherë punës. Poterja filloi të shtojte më shumë, kurse flaka që deri atëherë shkonte deri në qiell, filloi të bjerë. Sa më shumë shuhej flaka, aq më shumë ndizej poterja.

Kur zjarri ishte në të shuar plotësisht, ne zbritëm nga çatia triumfalisht dhe u futëm menjëherë në pellgun e asaj zhuzhurime bletësh.

— O burra, eni të futim kazmat brenda, — thirri dikush aty pranë meje.

— Të kujdesemi më parë për njerëzit, — bërtita unë me sa fuqi pata, — njeriu është kapitali më i çmuar...

Nuk munda të mbaroja fjalën, sepse në këtë çast dikush më shtyu me govatë dhe më hodhi përtokë.

— S'ka njerëz këtu, — më tha dikush, duke më qarë hallin se mos isha vrarë. — Këtu është lavanderi...

— Lavanderi?!

— Pse çuditësh, ka gjashtë muaj që është hapur.

— Gjashtë muaj, dhe unë s'di gjë?!

— Edhe unë tani vonë e kam marrë vesh. E nga ta marr vesh, këtu s'ka asnjë reklamë, asnjë tabelë dhe asnjë shenjë tjetër që të tregojë se këtu lahen rrobe...

Të nesërmen u hap në tërë qytetin se atë natë ishte djegur lavanderia. Dhe vetëm kështu e morën vesh qytetarët se në një nga lagjet e tyre paska patur lavanderi.

SËMUNDJE TRASHËGUESE

Mbase nuk na ka rënë rasti ndonjëherë të tregojmë një ndodhi të vogël mbi shokun Zyko Zykollarin.

Zykua, që thoni ju, sa herë që flet përsërit fjalëzën «domethënë». Domethënat e tij hyjnë si piper i kuq në mes të fjalëve, po megjithëse shpeshherë ja djegin gjuhën, nuk heq dorë prej tyre.

Këtë sëmundje e kishte dhe nëna e tij plakë, e cila fjalës «domethënë» i shtonte edhe «që thua ti».

Siç thamë, edhe pse Zykua e njihte këtë të mëte, ai përsëri fliste shpesh dhe kudo që të ndodhej. Sidomos nëpër mbledhje domethënat e tij qarkullonin si guri i mullirit kur vërtitet bosh dhe, pikërisht për këtë, ishte bërë i mërzitshëm. Djemuria ja numëronin këto dhe në fund të mbledhjes i paraqitnin faturën përkatëse.

Një ditë Zykos i zuri veshi se folën për të e thanë: Ai është i sëmurë, as mjekët nuk i bëjnë derman. E kanë trashëgim Zykollarët këtë sëmundje.

Zykos i dogjën këto fjalë dhe në darkë hapi një diskutim akademik me të ëmën. E ëma i tha:

— Edhe yt atë, ndjesë pastë, domethënë që thua ti, kur fliste thoshte shpesh «domethënë a më kupton», kurse xhaxhai yt thoshte «domethënë a mer vesh». Unë nuk e mbaj mend, por, domethënë që thua ti, thonë se dhe gjyshi yt thoshte shpesh «domethënë, domethënë».

— Domethënë, pse nuk thua ti, se këtë sëmunde e paskemi trashëgim.

E ëma ngriti supet dhe rrudhi buzët.

Pas kësaj bisede Zykua u tërhoq dhe u mbyll në dhomën e errët të mendimeve të tij. Tani nuk mendonte më për veten e tij se sa për fëmijët. Ai kishte pesë fëmijë dhe prej të pesëve vetëm për njërin dyshonte se ishte infektuar nga kjo sëmundje. Dhe nga qederi se mos infektoheshin edhe të tjerët, vendosi të shkonte për konsultim tek mjeku. Pse të mos shkoj, mendonte ai, fundi pse janë mjekët? Me këtë rast zhvatim dhe ndonjë raport. . .

Të nesërmen Zykua, me vendosmërinë që e karakterizonte, shkoi në ambulancë për t'u konsultuar me mjekun. Infermierja pasi i mori identitetin e pyeti:

— Kini temperaturë?

Zykua nuk foli, po e pa vëngër infermierën.

Ajo pa pritur përgjegje e pyeti përsëri:

— Ç'të dhemb?

— Si të them, domethënë. . .

— Ku do të shkoni, tek nevrologu, a tek otorinologu, a tek okulisti a. . . dhe, meqë infermierja nuk priti përsëri përgjegje, e adresoi tek patologu, duke menduar se gripi që ishte akoma në qarkullim e kishte mbërthyer edhe atë.

Me të bërë regjistrimin Zykua u fut në radhën e pacientëve. Ishte i gjashti, por meqë dy të tjerë pas tij kishin temperaturë të lartë e s'qëndronin dot më këmbë, kaloi automatikisht në të tetin dhe, pak më vonë u ngjit akoma dhe mbërriti në të parafundit.

Më në fund, pasi nuk bëri më lëshime, u fut në dhomën e vizitave.

— Veri termometrini! — urdhëroi mjeku infermieren.

— Shoku doktor...

Mjeku nuk i foli, po u muar me pacientë të tjerë që prisnin këshilla.

Zykua e mori termometrini e vuri në sjetull dhe pasi e mbajti ca e hoqi dhe ja dha infermieres. Ajo e pa, e shkundi dhe si shtrembëroi buzët e pyeti:

— Sa e kini patur mbrëmë temperaturën?

— Më falni shoqe, po, domethënë, unë nuk po kuptoj, domethënë s'di pse më pyesni për temperaturë.

— Është rregull, ndryshe mjeku nuk të viziton.


Zykua nuk i dha përgjegje, dhe ndejti një copë herë më këmbë si hu gardhi.

— Zhvishu! — bërtiti mjeku me një ton prej gjashtë ballësh.

— Shoku doktor, më falni, domethënë...

— Zhvishu, zhvishu — përsëriti mjeku dhe si i ngriti këmbësh Zykos, i vuri stetoskopin. — Merr frymë thellë... kollitu... kollitu fort... ja kështu kho, kho!

Zykua kollitej aq fort, sa gumëzhinte dhoma.



Mjeku, pasi uli buzët dhe ngriti vetullat përpjetë, i hodhi një sy kartelës. Pastaj e pyeti:

— Çfarë ju dhemb?

— Më falni, shoku doktor... domethënë, mua nuk më dhemb, domethënë, por...

— Po çfarë, mos kini ndonjë sëmundje dhe ju vjen turp ta thoni. Në mjekëve...

— Jo. Në, domethënë, unë dhe nëna ime kur flasim, domethënë, kur bëjmë muhabet përsërisim shpesh, domethënë, domethënë. Nëna më thotë se këtë lloj sëmundje e kanë patur ndjesë pastë dhe babai im, bile dhe gjyshi dhe xhaxhai, domethënë e kemi trashëgim.

Mjeku ktheu një copë herë kokën për të fshehur buzëqeshjen e tij, pastaj e ktheu sërish dhe shtrëngoi me dorë të dy bulçitë që të mos i pëlçisnin nga të qeshurit.

— Unë, — vijoi Zykua, — nuk kam hallin tim, po të fëmijëve. A është, domethënë trashëguese doktor?

— Derisa e kanë patur dhe të tjerë nga familja juaj, sigurisht që është trashëguese.

— Si i bëhet hallit, mos ka nevojë për ndonjë raport mjekësor?

— Është kollaj ajo punë, — tha mjeku, dhe pastaj ju drejtua infermieres:

— Duhet të bëjë analizat komplet, të gjakut, të urinës dhe të feçes.

— Më falni po, domethënë...

— S'ka domethënë e stërdomethënë, këtu urdhëroj unë. Të bëhen analizat dhe të më sillen sa më parë.

Zykua mori recetën nga dora e infermieres dhe u largua i turbulluar.

Të nesërmen ai ju nënshtrua analizave dhe, pasi mori rezultatet, ja dorëzoi mjekut.

Ai i pa shënimet e laboratorit, që ishin të tëra negativ dhe i tha:

— Duhet t'i përsëritni analizat, ju kanë dalë negativ.

Kur Zykua mendoi sa belara kishin analizat, sidomos marrja e gjakut, hoqi dorë prej tyre dhe tha:

— Në djall vafshin edhe domethënat e mija! — dhe vendosi t'i verë kapak kësaj pune.

Djemuria që e morën vesh punën e Zykos, i thoshin:

— Nga llogaritë që kemi bërë, na del se domethënat e tua janë pakësuar në minimum. Siç duket mjeku të paska shëruar.

Zykua u tundte kokën dhe i shikonte vëngër. «Keni të drejtë, — thoshte ai me mendje të tij, — derisa unë u bëra për doktor, por ah, të më shihni sot e tutje!» Ai vendosi që nëpër mbledhje të fliste pak e sak. Dhe me të vërtetë vetëm kjo kurë e shëroi Zykon nga kjo sëmundje trashëguese.

ARËSYETIM ARITHMETIK

Beharit m'u dha të shkoj në një kantier ndër-timi. Pasi u përshëndeta me shokët e drejtorisë i pyeta:

— Si jini me fuqinë punëtore, me trajtimin, kujdesin për ta?..

— Shumë mirë, s'kemi asnjë ankesë. Tani është behar, njeriu fle po të dojë dhe jashtë...

— Domethënë në këtë drejtim meritoni notën 10?

— Pa tjetër.

— Po me realizimin e planit si gjashtëmujor si jini?

— E kemi realizuar dhe tejkaluar.

— Atëherë, po i shtojmë 10-s dhe një zero prapa dhe na bëhen 100.

— Dakord.

— Po me kursimet, me uljen e kostos, me shfrytëzimin e rezervave të brëndshme?..

— Mjaft mirë. I kemi kursyer shtetit aq milion lekë, kemi ulur koston aq për qind, kemi

shfrytëzuar çdo gjë... Tani nëpër objektet tona nuk gjen asnjë gozhdë për tokë.

— Shumë mirë, atëherë 100-it po i shtojmë dhe një zero tjetër e na bëhen 1000... Po me cilësinë si jini?

— Deri tani nuk kemi patur asnjë reklamim nga punëdhënësit...


— Shumë bukur. Atëherë numrit të mëparshëm i shtojmë dhe një zero që të na bëhet 10.000... Besoj kjo shifër është e kënaqshme?

— Ju falemnderit!...

U largova me këta tregues aq të lartë.

Erdha përsëri në fund të vitit dhe pyeta shokët e drejtorisë:

— Si jini me fuqinë punëtore, me trajtimin, kujdesin për ta?..



— Jo mirë. Dimri erdhi pa na lajmëruar fare, dru s'kemi... Një ditë bëri shumë të ftohët dhe një pjesë e mirë e punëtorëve na u plevitosën...

— Domethënë notës 10 mund t'i vemë një kryq?

— Asaj ndoshta mund t'i vihet kryq, por ama me treguesit e tjerë jemi mirë.

— Në qoftë se numrit 10.000 i heqim njëshin, zerot e tjera që vijnë pas tij, nuk kanë asnjë vleftë.

Ata thanë:

— Ky është një arësyetim arithmetik shumë bindës, ndaj ne në të ardhmen do t'i kushtojmë rëndësi kryesore numrit 1.

SI DREJTOHET GOZHDA


Secili nga ne, në qytet apo në fshat, ka patur rast të shohë ndërtimin e një shtëpie, pallati, fabrike, kombinati. Me siguri ai ka parë se si lëvrijnë muratorët nëpër skela të larta, si i tërheqin tullat nga poshtë, si e gatujnë llaçin dhe më në fund se si, pasi mbarojnë ndërtesën, lënë nëpër sheshe materiale «të panevojshme».

Unë pashë një panoramë pak më të ndryshme. Vizitoja një fabrikë në ndërtim e sipër dhe, tek vështroja se si me anë të një rripi ngjiteshin lart tullat dhe llaçi, u gjenda përpara një djali, i cili kishte zënë një kënd në hije dhe drejtonte gozhdë.

Ai nuk më pa, por dhe unë nuk i fola po u fsheha pas një kolone. Ai fliste me vete:

— Kjo nuk bën!.. Kjo s'paska kokë... kjo qenka shumë e shtrembër... kjo qenka gjysmake... kjo qenka e ndryshkur... — dhe pasi thoshte kështu i hidhte mënjanë.

Në fund fare mbetën tri gozhdë të drejta dhe të reja, të cilat me siguri ishin futur kontrabandë në grumbullin e gozhdëve të shtrembëra.



Atëhere djali i nxehur nga ky rezultat qesharak ngriti përpjetë çekinin, qëlloi me sa pat fuqi të tri gozhdët e drejta, i shtrembëroi ato dhe, duke i hedhur me të tjerat, tha:

— Në djall të venë! Pyet ndërmarrja jonë për tri gozhdë.

Pas pak mbërriti një shok i brigadës së tij dhe e pyeti:

— Si venë punët?

— Nuk drejtohen, këto janë shtrembëruar për gamet!

— Të tëra nuk drejtohen?

— Ja, u drejtuan dy, tri... sa para bën.

— Ne kemi marrë zotim që të punojmë me gozhdë të dala jashtë përdorimit, — tha shoku.

— Ashtu është, por këto s'ka burrë që i drejton, — ja priti djali.

— Meqë s'drejtohen, flaki tutje, — i tha shoku.

— Mirë, ashtu bëjmë.

Pasi u mendua një çikë, i erdhi një ide në kokë: — Sa t'i flak tutje, — i tha shokut të tij, — më mirë t'i marr për vete.

— Ç'i do? — e pyeti ky.

— I rregullon lala këto, — rrahu gjoksin tjetri.

S'do mend se kësaj radhe djaloshin e tradhëtoi gjuha, që i foli para mendjes dhe menjëherë ai e ndjeu veten ngushtë, po ishte tepër vonë.

Atë çast shoku i tij i tha me një ton urdhërues:

— Meqë paskan mundësi të drejtohen, atëherë drejtoi, — dhe u largua, për të kontrolluar punëra të tjera.

Unë që rrija fshenur pas kolonës pashë se si djali i hyri punës tak e tuk, dhe se si brenda një kohe të shkurtër i drejtoi tërë gozhdët, bile dhe ato të rejat, që i kishte shtrembëruar mos më keq.

Kur po largohesha thashë me vete:

— Ja si mund të drejtohen gozhdët dhe...
ndërgjegjja.

PËRMBYTJA

Ndonjëherë, kur bie shi me shtëmba dhe shqërohet me ndonjë furtunë të fortë, mbrëmjeve dëgjoj radion që thotë se në filan shtet ky apo ailum doli nga shtrati dhe përmbyti filan fshat. Mirëpo mua përmbytja më ndodhi në rrethana krejt të ndryshme, bile të kundërta me ato që përmenda më lart.

Atë ditë që më lajmëruan se shtëpia ime ishte përmbytur, ishte mot i bukur dhe qielli ishte i kaltër, pa asnjë re. Kishte një javë që po bënte vapë dhe toka ishte djegur për ujë. Po megjithatë ja, shtëpia ime ishte përmbytur. E pabesueshme të duket, po natyra ka tekat e saj, s'di ç'bën. Në vend që të vadisë arat që u dëshiruan për një pikë ujë, vete e përmbyt shtëpinë time.

Zhvesha kominoshet dhe u nisa për në shtëpi me një frymë dhe me dyshimin se mos lajmi ishte lojë e ndonjë shakaxhiu. Por jo, kur arrita në trotuar të pallatit, pashë me sytë e mi se përmbytja ishte një realitet e jo shaka.


Fëmijët nën shkallë luanin me zhurmë. Ata bënë varka prej letre dhe i lëshonin në ujët që u vinte gjer te gjuri. Mua m'u desh të zbatthesha dhe të merrja shkallët përpjetë, prej të cilave uji binte si ujvare.

Një plakë, e cila po largonte me fshesë ujin që të mos hynte në apartamentin e saj, thirri:

— Eja, mor ditëzi, se u mbytëm!

Unë, që nuk dija akoma se çfarë kishte ndodhur, nuk i fola, po si një troftë që çan rrymën u turra drejt nga dera e apartamentit tim. Nga poshtë derës uji vërshonte me vrull.

Hapa derën dhe uji që ishte grumbulluar pas derës dhe mezi priste të dilte jashtë doli me vrull, duke marrë me vete dhe nallanet, pantoflat dhe lodrat e djalit, që i linte në sallon.



Vura duart në kokë dhe mbylla derën me të shpejtë, në mënyrë që uji mos të më rrëmbente edhe plaçka të tjera. Me të mbyllur derën, u turra me vrap për nga kuzhina, për të mbyllur rubinetin, që rridhte çurg. M'u kujtua se në mëngjez e lashë rubinetin hapur për të ftohur shalqinin. «Hej dreq! — thashë me vete. — Po unë e lashë të më ftohet shalqini e jo të më përmytet shtëpia!». .

U hodha një sy dhomave të përmytura dhe më pikonte në zemër kur shihja valixhet dhe plaçkat kaba që lundronin pa e prishur terezinë në atë det të qetë e pa dallgë.

Ç'të bësh, s'paska qenë kësmet të ha me lezet shalqinin. Se mos që ftohur thoni ju? Jo, or, jo, kishte dashur dhe pak...

TIPA TË PSONISUR

Kisha dalë në pazar, jo për të psonisur presh e lakra, pasi ato m'i ble babai që e kam pensionist, po për ndonjë tip për tregim. Pasi bëra disa sorollatje, u ndala para një dyqani zarzavatesh, i cili të tërhiqte vëmendjen me ekspozimin e bukur të mallrave.

Një person që ndodhej përkrah meje dhe që ju duk sikur unë do t'i zija radhën, u nxitua dhe pyeti shitësen:

- Sa është kilja e mollëve, shoqe?
 - Katër lekë e gjysmë.
 - Mollë «starking» nuk paski?
 - «Starking» janë këto, — u përgjegj shitësja.
 - A janë të ëmbla?
 - Sigurisht.
 - A mund të provojmë ndonjerën? — tha ai dhe u bë gati të nxjerrë briskun nga xhepi.
- Shitësja ngriti supet dhe nuk ju përgjegj. Ne që ishim vënë në radhë lëvizëm nga vendi dhe vumë buzën në gaz.

— Po lakrat sa janë? — vazhdoi ai pa na vënë re ne.

— Gjashtëdhjetë qindarka.

— Gjashtëdhjetë qindarka! Shumë. T'i marr me pesëdhjetë qindarka kilen ja priti klienti i panjohur.

Dikush i tha shitëses:

— Jepi një gjeth lakre ta provojë

Ne ja dhamë të qeshurit dhe ai na pa vëngër.

— Nuk kam kohë për shakara, shok, — ja priti shitësja dhe na u drejtua ne të tjerëve.

— Nuk bëj shakara, shoqe, — ja ktheu ai me të nxehur, — kam dalë për të psonisur.

«Ja, — thashë me vete, — tipi që kërkoj» dhe vendosa t'i qepem pas.

Pasi bëri disa hapa tutje, takoi me një shokun e tij. Nga fjalët e para që shkëmbyen njëri me tjetrin, mësova se tipin që kërkoja e quanin Shpend dhe atë tjetrin Fetah.

— Paske dalë për të psonisur, o Fetah? — pyeti ai.

— Ç'të bësh, o Shpend, duhet t'i ndihmojmë gratë. Lodhen këputen...

— Ashtu është. Nuk i thonë shaka: punë në shtëpi, gjella duhet gatuar, fëmijët duan, ne, kur i thonë fjalës, duam pakëz hyzmet... Unë për veten time e kam ndihmuar dhe e ndihmoj vazhdimisht gruan. Disa punë shtëpie, e sidomos psonitë, i bëj vetë. Kjo është detyra ime kryesore. Apo s'ja kam marrë dorën pazarit...

— Kështu bëj edhe unë, — ja priti Fetahu dhe i tregoi rrjetën e mbushur plot e përplot me zarzavate.

Bënë disa hapa tutje duke u qarë hallin grave. Pastaj Shpendi pyeti:

— Paske marrë patate të mira, tamam si mollë.

— Janë panxhar, — tha Fetahu. Shpendi uli kokën e nuk foli.

— Dua të blej kripë, — e theu heshtjen Fetahu, — por s'di ku e kanë degdisur dyqanin e kripës.

— Eja vemi bashkë, — tha Shpendi, — pasi edhe mua më ka porositur gruaja të blej kripë.

— Sa do të marrësh ti? — e pyeti Fetahu.

— Njëqind lekë.

— Mua, që jam më pak frymë, besoj se më mjaftojnë pesëdhjetë lekë, — tha Fetahu.

Të udhëhequr nga Shpendi, ata u futën në dyqan të kripës.

— Shoqe! — tha Shpendi, — më jep njëqind lekë kripë, kurse këtij shokut pesëdhjetë lekë.

— Si urdhëron, — tundi kokën Fetahu në shenjë aprovimi.

— Kini ku ta futni? — pyeti shitësja.

Shpendi nxori nga rrjeta një qeskë letre dhe ja zgjati shitëses.

— Kjo letër nuk mjafton, — tha buzëgaz shitësja. — Duhet thes. Njëqind lekë kripë, në mos gabohem, bëjnë 14 kilogram e ca.

— Pse, moj shoqe, kur qenka bërë kripa kaq e lirë? — u hodh e tha Shpendi, i cili e hiqte veten sikur ja kishte marrë dorën pazarit.

— Kripa e lirë ka qenë kurdoherë, — tha shitësja.

Shpendi rrudhi buzët dhe tundi kokën në shenjë habie.

— S'kini faj, — tha shitësja, — ju të dy, sig duket, jini nga ata burra që nuk u ndihmoni grave.

Shpendi dhe Fetahu desh kundërshtuan, por kësaj radhe nuk bënë zë, pasi u zunë mat me një lëvizje.

Fetahu dhe Shpendi u larguan pa blerë kripë, dhe nga hutimi harruan të përshëndeteshin, kurse unë mbeta me bllok në dorë, i gëzuar që pazari më vajti mbarë...

MIU

Inxhinieri i ndërmarrjes sonë, pasi merr njoftim për disa shkresa, i fut përsëri në dosje dhe ja jep përgjegjëses së administratës që ja ka sjellë. Pastaj mbështet bërrylat mbi tavolinë, mbulon veshët me pëllëmbët e duarve dhe pas pak zhytet në punë. Ndërkohë qetësinë e prish zilja e telefonit. Ai kap dorezën dhe kërkon të dëgjojë se kush është, por jashtë bëhet potere dhe s'merret vesh gjë. Thërret me zë të lartë që të pushojë shamata, po ajo përkundrazi shtohet më shumë.

— Bjeri, bjeri... qëllaje derrin!...

Inxhinieri nevrifikoset dhe rend në dritare për të parë se çfarë bëhet përjashta.

— Ç'keni more, që thërrisni kështu?

— Miu, shoku inxhinier, goxha mi, — përgjigjet njëri, duke mbledhur të dy grushtet.

— Për një mi thërrisni kështu...

Ndërkohë miu del nga vrima ku ishte futur dhe vrapon si shigjetë.

— Doli, doli... bjeri, bjeri...

Miu kthehet me një shpejtësi të çuditëshme dhe futet fishek përsëri në vrimë.

— Jazëk ju qoftë! — mallëkon inxhinieri që bën sehir nga dritarja. Dy burra dhe s'vrisni dot një mi.

— Është i madh, shoku inxhinier.

— Të marrim ndonjë dru, — thërret njeri.

— Mirë i kemi gurët, — ja pret tjetri.

— Me dru është më mirë, — u kujton inxhinieri.

Koha ishte e bukur dhe dielli përvëlonte. Një re e bardhë si një boçe e madhe pambuku rrinte pezull dhe dukej sikur të qe lidhur nga lart me fije peri të padukshëm. Të dy burrat që merrnin pjesë në këtë aksion kishin hequr këmishat dhe i kishin varur mbi parmakët e lulishtes së ndër-marrjes.

Miu del përsëri nga vrima, rend si vetëtima dhe, pasi çan rrethimin, futet në një qyngj të vogël që shërben hem si urë, hem si kanal. Po kur sheh se ky vend nuk është shumë i sigurtë, merr sërish forca të reja, del nga qyngji dhe, duke kaluar mes për mes fushës së betejës, futet përsëri në vrimën e parë.

— As kësaj radhe nuk e qëlluat? Ju s'paskëshit qenë për asgjë. — thërret inxhinieri nga dritarja e zyrës së tij dhe del me vrap në fushën e betejës. Pas pak, të gjithë, sipas urdhërave të inxhinierit, vihen në formacion luftimi.

Disa punëtorë ngarkim-shkarkimi që po ngarkonin një arkë të madhe mbi një karro, vazhduan punën edhe pse inxhinieri herë pas here u bënte

thirrje që të zbrisnin në fushën e betejës. Vetëm kuzhinieri i mencës së punëtorëve, kur mori vesh se ishte ai miu që s'u linte kusur ushqimeve, la gjellën mbi zjarr dhe u fut në... valle. Kater vetë në gatishmëri luftarake. Tetë sy i janë mbërthyer vrimës ku është futur miu, e tërë vëmendja, tërë energjitë janë përqëndruar në një pikë të vetme, nga varet fati i miut.


Inxhinieri i afrohet vrimës me një kopaçe të madhe në dorë, por fatkeqësisht aksioni nuk përfundon me sukses, sepse miu sikur t'i kishte zbuluar planet e armikut del nga vrima si ndonjë predhë topi.

— Bjeri! — ulëriti fusha e betejës, sa u tronditën tërë minjtë e mëhallës. Në qoftë se është e vërtetë se miut i rreh zemra treqind herë në minutë, në atë çast me siguri i rrihte pesëqind, ndosh-ta dhe gjashtëqind herë në minutë.

E goditura e një guri i kishte këputur bishtin dhe një e goditur tjetër i kishte sakatuar njerën këmbë, po për fat miut i mjaftonin edhe tri këmbë.

Miu duke përfituar nga dobësitë strategjike dhe taktike të armikut u fut në korridorin e zyrave (rrugë të cilën e kishin lënë zbuluar) dhe që andej në zyrën e llogarisë, të cilën e njihte fare mirë. Por, kur ndjeu se u lëkund tërë dyshemeja nga këmbët e armiqve sulmonjës, u vërsul me forcat e tij në zyrën tjetër ku rrinin teknikët dhe normistët. Dy vajza disenjatore që s'dinin se ç'bëhej, ja dhanë kujos sa u vajti zëri në kupë të qiellit.

— Ç'kini që ulëriti kështu moj, ju marrtë... (këtu inxhinieri e mbajti gojën). Vajzat kur panë tërë këtë ushtri, dikë të zbërthyer me këmishë



jashtë pantallonave, dikë pa këmishë fare e të mbytur në djersë, kafshuan buzët që të mos ja plasnin gazit.

Ngaqë hynë të tërë menjëherë, u derdh një shishe boje mbi një skicë, kurse mbi një tavolinë tjetër u rrokullis dhe u bë copë një poçe uji e cila bëri punën e saj mbi disa shkresa dhe skica. Po këto as që i vunë re sulmonjësit, pasi puna e tyre kryesore ishte që të asgjësohej armiku që kishte më se një orë që po i mundonte.

Miu nxjerr kokën për të kontrolluar gjendjen e forcave të armikut dhe futet përsëri pas një rafti që s'tundej nga vendi. Po ja që atij s'i rrihet. Ndoshta ka vendosur t'i lodhë e t'i këputë, derisa

të heqin dorë vullnetarisht nga ky sulm i pabara-
bartë.

Nxjerr kokën përsëri, përgjon se çfarë flitet,
por fatkeqësisht nuk kupton gjë. Mbasi studjon ven-
din del nga ajo llogore e sigurtë ku ishte futur dhe,
pasi ngjitet nëpër faqet e murit, futet në vrimën
ku kalon tubi i sobës, që e nxjerr tymin jashtë.

Njëri që ruante derën, kur pa se miu po ngjitej
në mur, qëlloi me sa fuqi kishte, por në vend që të
godiste miun, druri goditi parullën e varur ku
shkruhej me gërma të kuqe: «Koha është flori». Atë
çast, u ndie një zhurmë aq e tmerrshme, sa të gjithë
mbetën gojë hapur.

Për një çast pllakosi heshtja. Dhe këtë hesht-
je i pari e theu kuzhinieri, i cili kur nuhati se po
i digjej gjella në zjarr ja dha vrapit.

Inxhinieri, mbeti një copë herë në këmbë si i
shastisur dhe pastaj u kthye kokëunjur në zyrë. I
hodhi një sy orës së murit, kishte kaluar afro një
orë. Ndërkohë në zyrën e tij hyn një nga disenja-
toret dhe pyet me djallëzi:

— E vratë miun?

— Jo, — u përgjegj inxhinieri i mërzhitur, —
vramë kohën...

ARIU

Para se të njihesha me njeriun për të cilin do t'ju flas më poshtë, në kokën time nuk gjeje asnjë qime floku të zbardhur.

Një ditë, tek isha i kërrusur mbi disa skica teknike të një studeti, troket dera: Tak-tak-tak. Tri herë, as më shumë, as më pak.

— Hyrë!

— ...

— Hyrë! — bërtita përsëri.

Pasi nuk mora asnjë përgjegje, mendova se me kishin bërë veshët dhe, kësisoj, vijova punën.

Përsëri: tak-tak-tak.

Kësaj radhe, duke kujtuar se dikush tallej me mua, u ngrita tërë nerva dhe hapa derën me forcë.

Papritur u gjenda përballë një gjoksi leshtor që të kujtonte ariun.

M'u zgërdhi dhe, me një buzëqeshje naive, që nuk i shkonte fare, më pyeti:

— Ju jini profesor Nimeti?

Para një sjellje të tillë unë u çarmatosa dhe, pasi pohova me kokë, e futa në zyrë.

Pasi u ulëm përballë njëri-tjetrit dhe si këmbuem shikimet e zakonshme, më tha:

— Kini të fala nga inxhinier Besim Shahu. Është kunati im...

E falenderova që më solli të falat e një kolegu të vjetër dhe u interesova gjatë e gjerë për shëndetin e punën e tij.

Pas këtyre shpjegimeve, me lejën time ai u fut në temë. Që të mos ju mërzis me hollësira të kota, qëllimi kryesor i kësaj vizite të papritur ishte që unë të ndërmytësoja atje ku duhet e t'i ndërroja profilin e studimeve të tij, konkretisht nga fakulteti ekonomik të kalonte në atë të mjekësisë.

— Kam dëshirë të zjarhtë të bëhem mjek... Kam një farë prirjeje... Ekonomiku s'më pëlqen... S'di pse më është mbushur mendja se do të bëhem mjek i zoti... Me sa më tha kunati, ju e kini mirë me ata të fakultetit të mjekësisë, — përfundoi.

— Kjo është vështirë të bëhet. Kontigjenti i studentëve është i planifikuar. Pastaj këto punë...

— E di, — më ndërpreu — por po të doni ju, bëhet gjithshka.

Qe e kotë t'i mbushja mendjen.


Pas disa sulmeve e kundërsulmeve, biseda na u ndërpre dhe secili nga ne mbeti në llogoren e mendimeve të tij.

Të nesërmen, ndoshta po atë orë, përsëri trokiti dera: tak-tak-tak. Përsëri tri herë. Përsëri ngrihem dhe e hap i nevrikosur. Përsëri më del përballë ky tip ariu, përsëri po atë avaz:

«Po të doni ju bëhet gjithshka...»

Po të kishte përfunduar me aq, çdo kusur do t'ja kisha falur, por për fat të keq kjo punë u ntrash aq shumë, sa që takimet jozyrtare i shtrinë krahët dhe në shtëpi, edhe në rrugë, edhe në bibliotekë, edhe në donjë rostiçeri. Dhe jo vetëm ditën, por dhe natën.

U bëra nervoz dhe flokët filluan të më thinjen një nga një. Disa do të thonë:



— Mirë, mor shoku Nimet, po pse nuk e sikterise? Këta tipa kështu e duan.

Kini të drejtë. Pikërisht për këtë desha t'ju them.

Një ditë, kur ai më kishte ardhur në zyrë, i thashë se bëhesha gati të shkoja në punë vullne-

tare, pasi më prisnin studentët. Dhe këtë ja thashë me qëllim që të më shporrej, por...

Dolëm. Kodrat pas universitetit ishin zhytur në gjelbërim. Drunjtë shushurinin nga era, por unë nuk e kisha mendjen aty, pasi në rrëzë të veshit më shushurinte ai. Unë nga inati nuk flisja fare. Kur mbëritëm në buzë të liqenit, i thashë:

— Kthehuni ju!

— S'ka gjë, — më tha, — po ju shoqëroj deri në vend.

— Kthehuni, pse të lodheni kot!...

Ishte e kotë t'ja mbushja mendjen.

Vazhduam rrugën buzë liqenit, pikërisht atë rrugë që të shpie në kopshtin zoologjik.

Pas pak u gjendëm para kopshtit. Hymë brenda. Në fillim u takuam me stërgjyshërit tanë, të cilët, siç duket, ishin në orën e gjimnastikës së mëngjezit dhe s'kishin nge të merreshin me ne.

Pastaj vizituam me radhë baldosën, vjerdullën, shqiponjat, fajkojtë, fazanet, ujqit, dhelprat; riqebullin dhe u ndalëm tek ariu. S'di pse më tërhoqi vëmendjen kjo kafshë. Padashur i hodha një sy shoqëruesit tim dhe vura re se nga ana e jashtme i ngjante shumë kësaj kafshe të murme dhe të stërmadhe.

— Hape gojën, Mishka, hape, hape fort! fort! — i thoshte një fëmijë i vogël. Dhe ariu, duke kujtuar se do t'i hidhte diçka për të ngrënë, hapte gojën e tij si një kamare. Hape! Hape fort! Dhe ariu përsëri hapte gojën me ata dhëmbë të mprehtë e atë gjuhë të trashë, që i dridhej e i mbushej me jargë, me atë qiellzë ngjyrë gjaku të errët që, kur e kujtoj, edhe sot më rrënoqethet mishtë...

— Ç'gojë të llahtarshme paska! — më tha shoqëruesi.

Kjo s'është gjë, — i thashë. — Ka edhe më keq.

— Thonë se ariu nuk i ha të vdekurit, a është e vërtetë?

Unë që deri atëherë isha bërë vrer, gjeta më në fund rastin e ju zbraza:

— Po, është e vërtetë. Ariu ha vetëm të gjallët, i kullufit menjëherë, kurse ti je nga ata arinj që të cflitin e të hanë dalëngadalë, të hanë e të lenë gjallë e për gazep.

K U R S I M T A R I

Pallati i ri pesëkatësh që u ndërtua në një mëngë të qytetit, akoma nuk ishte zhveshur nga skelat dhe nga zinxhirët e vinçave që vareshin fasadave! Njëpër anët e trotuarëve të binin nësy togje llaçi, grumbuj tullash të thyera, copa të këputura soletash e betonarmeje. Në një llamarinë të xinguar dikush kishte shkruar me bojë të kuqe parullën: «Të forcojmë regjimin e kursimit».

I tërë kati i parë, sipas projektit, ishte lënë për lokale. Dhe, tani njëpër këto lokale hynin ditë për ditë një grup njerëzish, që dukeshin të zënë me punë. Ata hynin e dilnin duke e kërrusur nëpër tubacionet e skelave, duke shkëlur njëpër pellgje gëlqereje dhe llaçi, duke penguar punëtorët që punonin me nxitim për t'i dhënë dorën e fundit pallatit në prag të dorëzimit.

Këta ishin përfaqësuesit e tregëtisë dhe të artizanatit. Të parët ëndërronin një bar-bufë luksi, kurse të dytët synonin shtrirjen e rrjetit të artizanatit në periferi.

Ndërmjet dy palëve, në lokalet e reja ku zëri jehon si ushëtimë, bëheshin ditë për ditë debate të forta. Dhe ushëtimja e këtyre debateve shkonte deri në organet më të larta.

Një ditë në lokalet e katit të parë erdhi vetëm njëra palë, ajo e tregëtisë. Nuk dihet se si e qysh, po ata e kishin fituar davanë. Ata tani flisnin me zë të lartë. Ai që fliste quhej Demo dhe ishte vetë drejtori. Kishte një zë baritoni, tingulli i të cilit ngrihej edhe një notë më lart në ushëtimën e lokalit të ri. Ai ju kthye vartësve të tij:

— Shokë, ky lokal është i përshtatshëm për bar-bufe, për një çlodhje të kulturuar. Kini për të parë po nuk na ngritën dolli qytetarët.

— Si urdhëron, shoku Demo. E drejtë, — tha shefi i investimeve.

Shoku Demo ju drejtua përgjegjësit të dekorit:

— Shija e hollë dhe estetika luajnë një rol të dorës së parë...

— Reklami është shpirti i tregëtisë, — tha përgjegjësi i dekorit.

Të nesërmen puna nisi me vrull revolucionar. Marangozë, bojaxhinj, piktorë, elektrohidraulikë, tapicierë. Raftet, banakët, mobiljet u bënë pa përjashtim me rimeso arre dhe me llustër. Tavolinave përveç llustrës ju vu syprinë prej xhami të kristaltë, kolltukët u veshën me lëkurë të butë shevroje, vitrinat u mbuluan me dy palë perde, një palë të holla e transparente dhe, një palë me damask të rëndë. Kolonat u veshën gjithashtu me lëkurë të butë, po në formë pliseje.

Kureshtarët shtoheshin ditë per ditë tek hyrjet e këtij lokali. Atyre u binte në sy diçka e çuditshme dhe habiteshin. Ata i habiste variacioni, ndryshimi i papritur që pësonte lokali brenda njëzet e katër orëve. Dje ngjyra e lëkurës së kolltukëve kishte qenë kafe e errët, sot kolltukët kishin një ngjyrë kakao të çelët. Rimesoja e errët e mobiljeve qe zëvendësuar me panjë të bardhë. Këtë metamorfozë dinte ta shpjegonte vetëm shoku Demo, i cili u drejtohej herë pas here vartësve të tij.


— Shokë, nuk duhet nënvleftësuar mendimi kolegjal. Një fjalë e urtë e popullit thotë: «pyet njëqind vetë dhe bëj si di vetë». Sot shoku Rako, që njihet si njeri me shije të hollë, më bëri një vërejtje me vend. Ai më tha: «Ne jemi një vend mesdhetar, plot dritë e diell, prandaj hiq dorë nga ngjyrat e errëta, shoku Demo». Vërejtje me vend shokë, si thoni ju?

Ai foli përsëri për rëndësinë e regjimit të kursimit. Dhe sa herë fliste për këtë pikë, sytë ja mbërthente parullës së shkruar në llamarinë.

Të nesërmen rimesoja e arrës me ngjyrë të errët, u shkep nga mobiljet dhe u zëvendësua me rimeso të bardhë panje. Gjithashtu lëkurët e kolltugeve dhe të kolonave ngjyrë kafe, u hoqën dhe u zëvendësuan me boks bojë krem.

Një ditë në rrugë e ndaloi Kenua. Ai i foli me shumë pasion për lokalet e reja. Gjithshka i kishte pëlqyer pa masë, me përjashtim të ngjyrës së mureve:

— I keni dhënë një jeshile të fortë. Kjo ngjyrë, më fal se ta them, shoku Demo, të kujton teqetë dhe dervishlerët.



Demua u bë nervoz:

— Po ç'ngjyrë t'i jepnim sipas teje, shoku Keno?

— Krem, rozë, lejla...

Demua psherëtiu:

— I dhamë edhe krem edhe lejla, po s'ma mbushi syrin. Bojë rozë nuk e kemi provuar.

— E shikon, këtu qëndron gabimi. Provojeni një herë rozën...

— Nuk thua keq, do ta provojmë dhe atë, — ja priti Demua dhe nxitoi që ta vejë në zbatim sa më parë propozimin e shokut Keno.

Po nuk arriti të vejë në zbatim propozimin e shokut Keno pasi kësaj radhe jo vetëm kutiat me bojë rozë por edhe kupa ishte mbushur plot.

RROBALARËSJA

Më herët se kushdo tjetër në çerdhen e fëmijve të lagjes sonë vjen Merjemja. Ajo është rrobalarësja. Ka mbi dhjetë vjet që lanë çarçafët, pecetat dhe pelenat e fëmijve të çerdhes. Është një grua e hajthme, por plot energji, me ca krahë e duar të gjata, thujse natyra ja ka falur enkas për të larë rrobat në govatë.

Pasi grindet një copë herë me rojen, i cili në atë kohë bën gjumin e tretë dhe përton të hapë portën, Merjemja ndez zjarrin, pregatit lambikun, i fut rrobat brënda që të valojnë dhe, pasi ha një kafshitë bukë të thekur në zjarr, ja fillon punës. Kur vijnë edukatorët dhe fëmijët në çerdhe, ajo ka larë një pjesë të mirë të rrobeve. Fëmijët, nga kureshtja mblidhen rreth govatës dhe shohin teze Merjemen që rreh me kopan me sa fuqi ka çarçafët e bardhë si dëbora. Ata shtyhen të marrin pakëz nga ajo shkuma e sapunit që zbardhëllon mbi govatë dhe gajasen së qeshuri kur ndonjëri prej tyre laget nga stërkalat që për-

hap kopani. Rrobalarësja ju flet: «Largohuni, fëmijë! Largohuni se do të lageni!»

Pëllëmbët e duarve Merjemës i janë zbardhur e fishkur, po kur mendon se puna e saj sjellë pastërti ndër fëmijët, i mbledh forcat dhe hidhet më me vrull mbi govatë, për të larë e fërkuar mirë zhulin dhe njollat e çerçafëve dhe pelenave të fëmijëve.

Dimrit dhe në kohët me shi Merjemja nuk mërzitet nga vështirësitë e punës, pasi me ato është mësuar, por qahet nga mungesa e vendit për tharjen e teshave.

Në të ftohtët e hidhur ndonjëra nga edukatorët, kur e sheh teze Merjemën që fut duart sa në kazan me ujë të ftohtë akull, sa në atë me ujë të nxehtë valë, i qan hallin dhe e mallëkon këtë punë të rëndë, por rrobalarësja i pret në heshtje këto ngushillime. Asaj i duket sikur s'është e zonja të bëjë ndonjë punë tjetër, me përjashtim të larjes së lëvereve. Ka kaq vjet që bën këtë punë ndaj nuk sheh këtu ndonjë gjë të pazakontë.

Një ditë në oborrin e çerdhes u shkarkua një arkë e madhe dhe u vendos në vedin ku lahe-shin rrobet. Teze Merjemja, pasi ndihmoi për ta vënë në një vend të sigurtë, që të mos e rrihte shiu dielli, pyeti drejtoreshën e çerdhes:


— Ç'është kjo kështu?

— Larëse rrobesh, — ju përgjegj drejtoresha.
— Tani e tutje do t'i lajmë rrobet në këtë maqinë.

Rrobalarësja mbeti për një çast e hutuar.

— Ti nuk do të lash më rrobe, — vërejtí drejtoresha, — do të shpëtosh njëherë e mirë nga telashet.

Merjemja filloi të ndjente një farë urrejtjeje për këtë maqinë të pashpirtë, e cila pa pritur e pa



kujtuar erdhi t'i zërë vendin asaj, që për dhjetë vjet me radhë ka punuar me ndërgjegje të plotë dhe të pastër.

— Po unë ku do të vete? — ngriti kryet Merjemja, pa arësytuar më tej.

— Edhe për ty kemi menduar, — ja priti drejtoresha. — Do të të shpiem në një punë tjetër shumë më të mirë se kjo që bën këtu tek ne.

Merjemja, e cila nuk dinte se si mund të ishte ajo puna tjetër, nuk u zuri besë fjalëve të drejtoreshës, por këtë mosbesim e ndrydhi në veten e saj.

Rrobalarësen e çuan me punë në fabrikën e cingareve. E mori përgjegjësja e repartit, e i tha:

— Do të rrish në këtë stol. Nga kjo arkë do të zgjedhësh fletët e duhanit. Ato që janë të dëmtuara do të hidhen në këtë arkë, dhe ato që janë të plota në arkën tjetër.

— Vetëm kaq? — pyeti rrobalarësja.

— Vetëm kaq, — pohoi me kokë përgjegjësja.

Merjemja u ul dhe filloi nga puna. Tani ajo nuk e ndjente veten të vetme, si në lavanderinë e çerdhes, po në mes të shoqeve të saj, që e pritën dhe e ndihmuan për të mësuar punën e re. Kësisoj, mosbesimi ndaj fjalëve të drejtoreshës si dhe mëria që kishte krijuar për maqinën larëse filluan dalëngadalë t'i largohen. Tani për atë maqinë të pashpirtë, e cila zëvendësoi një shpirt që lodhej aq shumë, ndjente respekt dhe uronte nga zemra që kjo lloj maqine të përhapet kudo, që të zëvendësojë e të lehtësojë një punë aq të rëndë e të lodhshme për gratë.

QENI DHE MACJA

Unë e kam thënë një herë dhe do ta them vazhdimisht se është më mirë të kesh një tufë kalamajsh, se sa një qen dhe një mace. Të dy janë tipa të çuditshëm, të veremosin, të hanë shpirtin, njeri është më nevrrik se tjetri. Macja qimebutë e heq veten të zgjuar, kurse qeni bablok e shtatmadh hiqet si filozof, por që të dy bëjnë not dhe të padisiplinuar. Sipas rregullave të edukatës, macja, si më e vogël që është, duhet ti bëjë rrugë bablokut, po ajo e do në lule të ballit. Në ato sytë e saj, që në errësirë shndrisin si dy llampadina, fshihet tërë dinakëria dhe hipokrizia, kurse qeni, edhe pse ka doza dinakërie, nuk është hipokrit. Babloku mundohet të jetë i përpiktë dhe besnik ndaj tërë atyre të shtëpisë, jo për të fituar ndonjë simpati, po se kështu ja do nderi dhe edukata që ka marrë qysh në vogëli. Po të shprehemi me tema shkencore, macja dhe qeni janë dy forca të kundërta dhe në kontradiktë antagoniste me njëra-tjetrën. Ata janë kryeneçë, nuk i bëjnë rrugë


shoshoqit dhe, po qe se kacafyten njëri me tjetrin, kanë borxh të ngrenë tërë mëhallën më këmbë.

Ja ç'ndodhi një herë në një fshat ku dëborra hedh rrënjë në një pjesë të madhe të vitit. Një natë në shtëpinë e Tahir Shkëmbit, shkëmb edhe në ruajtjen e zakoneve të vjetra, erdhën dy miq për darkë, burrë dhe grua. Ishin njerëz të afërm të shtëpisë, ndaj dhe qeni në shenjë mikpritje lehu shumë pak, kurse macja, e cila në kësi rastesh nuk çan kokën fare, nuk u ndie. Pasi u përshëndetën dhe u rrokën në qafë me të zotët e shtëpisë, mysafirët u ndanë, gruaja shkoi në odën pa tavan, kur rrinin gratë, kurse burri u fut në odën e miqve, që ishte rregulluar para dy vjetësh.

Të zotët e shtëpisë, poqën kafënë dhe pas pak shtruan si zakonisht rakinë. Pastaj nisi muhabeti që në malësi quhet «muhabet burrash». Mirëpo qeni, pas muhabetit të burrave lë kokën, ndaj bën çmos që të futet në odën e miqve. Megjithëse i zoti i shtëpisë e nxori dy-tri herë jashtë qenin, se nuk deshë që ai të futë hundët në muhabetin e burrave, ai përsëri gjeti mundësinë dhe u fut brenda. Babloku bëri përpjekje, jo se ja ka qejfi të hedhë ndonjë gotë, po ai është kureshtar të dëgjojë muhabetin e burrave, ç'flasin e ç'thonë ata. Ai për t'i dëgjuar më mirë ato muhabete tërë kripë, herë pas here ngre veshët dhe, kur burrat fillojnë të këputin sa të trasha të holla, për respekt nuk qesh, po tund bishtin, shenjë kjo që tregon se i pëlqejnë qyfyret. Sa herë që ngrihen shëndete për të zotin e shtëpisë ose për mikun, bablokut i bëhet qejfi dhe, pasi e shoqëron deri në fund gotën e cila zbrazet në gurmaz, thotë me vete: «hajt t'u bëftë gjak e

dhjamë» dhe pret që të regjistrojë gotën që ti e mbush për së dyti e për së treti.

Kur sheh se burrat nuk ja varin më, babloku i hedh sytë nga fëmijët, të cilët një lloj si ai, as nuk hanë as nuk pinë, por vështrojnë e dëgjojnë baballarët e tyre tek bëjnë muhabet. Ndonjëri prej tyre qesh me të madhe bashkë me burrat, atëherë babloku u afrohet fëmijëve për të mësuar arësyen e të qeshurit, por kur ata në vend që ta sqarojnë i këputin ndonjë pëllëmbë turinjve, ai largohet i fyer, qëndron atje ku ishte më parë dhe vazhdon të numërojë kafshatat e të mbajë llogari.



Mirëpo tërë këtë muhabet e gaz që ka sjellë rakija e prish macja. Ajo që deri atëherë s'është merakosur për muhabetin e burrave dhe s'është ndier fare, rrëmben një copë mëlçi të pjekur nga pjata e mikut dhe futet nën baule. Inatin e maces i zoti i shtëpisë ja shkarkon bablokut, i cili

vonë e merr vesh pse e kopanisën. Nuk është hera e parë që babloku rrihet për hatër të maces, ndaj ai ja ka bërë benë asaj.

Kur u shtrua sofa për të ngrënë darkë, bablokut ju paraqit një rast shumë i goditur, por macja i shkau dhe u fut në sofër. Ai tundi kokën me hidhërim dhe mallëkoi veten që e kishte shtatin sa një kërraç gomari e s'futej dot nën sofër. Meqë nuk e përmbushi dot këtë dëshirë, ndejti tre hapa larg atyre që hanin dhe filloi t'i shihte një për një tërë ata që përtypeshin, gëlltitnin gjellë me mish dhe, megjithëse nuk hante vetë, kënaqej kur hanin të tjerët.

I mallëngjyer nga morali i lartë i bablokut, njëri nga burrat i hodhi një kockë, të cilën ai e kapi fluturim dhe u hoq mënjanë për ta gdhendur me nge.

Më në fund barqet e burrave u nginë, përtypjet pushuan dhe, si u shkundën thërrimet, sofa u ngrit.

Babloku dhe macja i lanë burrat duke gogësitur dhe rendën në odën e grave, për të parë kur të shtrohej sofa e dytë. Edhe këtu ata ndoqën taktikën e tyre të zakonshme. Macja u fut nën sofër dhe babloku qëndroi mu si hu gardhi tre hapa larg sofrës së shtruar. Babloku vuri re se të ngrënit e grave që shumë më e thjeshtë se ai i burrave dhe zgjati pak.

Edhe këtu macja, duke vënë në jetë aftësitë dhe talentin e saj, rrëmbeu nga dora e një gruaje thelën e mishit, po kur bëri të ikte, u ndesh ballë për ballë me bablokun, i cili deri atëhere, krahas detyrave të tjera, po përgjonte edhe lëvizjet e saj.

Qenit i hipën rrebet nga ky gjest i ulët i maces dhe për të shprehur zemërimin e tij ulëriti me sa fuqi kishte.

Ndoshta me këtë ulërimë¹ desh të thosh: «Moj shpirtkazmë, moj e pabesë, edhe atë copë mish që teproi nga sofrë e burrave kërkon t'ja heqësh nga goja asaj gruaje, a nuk di ti se unë jam besnik jo vetëm për burrat, por edhe për gratë, dhe, pasi ja dha edhe një ulërimë tjetër, që e ngriti peshë odën e burrave, e mbërtheu macen për gryke dhe, pasi u përleshën, doli jashtë dhe u fsheh në errësirë.

KAPOTA

Nurçja, mitralieri i kompanisë sonë, ishte partizani më i dobët e më thatiq nga gjithë të tjerët. Ç'është më keq ai ishte veshur edhe me rrobe doku dhe mërdhihte më shumë se kushdo tjetër. S'mjaf-tonte kjo, po dhe shiu dukej, sikur bënte çmos që mitralierin tonë ta lagte sa më shumë. Kjo dukej sheshit. Atëherë kur Nurçja sapo dilte nga baza, ku ish tharë e thekur mirë e mirë, shiu, sikur ja bënte për inat binte mbi të pa mëshirë. I ziu Nurçe! S'hahet inat me shiun.

Një ditë komandanti i kompanisë i tha:

— Me të rënë në ndonjë luftim me gjermanët, kapotën e parë që do të zemë, do të ta japim ty.

Këtë dëshirë kishin dhe partizanët e tjerë, të cilët ishin më të shëndetshëm se Nurçja.

Dhe me të vërtetë, pas një beteje me gjermanët, ku u shqua për trimëri dhe mitralieri Nurçe, komandanti i kompanisë në mes plaçkave të tjera që i rrëmbeu armikut, psonisi dhe një kapotë, të cilën ja dha menjëherë Nurçes.

Atij i vinte pak si e gjatë dhe e madhe, sa të

fusje dy Nurçe brenda, po ai e veshi pa i vënë re fare këto të meta. Partizanët e uruan për kapotën e re (megjithëse atë çast ajo ishte llangosur me baltë) dhe u erdhi mirë që më në fund edhe Nurçja u vesh mirë e nuk do të ankohej më nga të ftohtët.

Kapotën ai e ruante si sytë e ballit, sepse ajo i bënte ballë dy armiqve më të mërzitshëm të Nurçes, shiut dhe të ftohtit, ndaj, sa mbërrinte në ndonjë bazë e hiqte, e thante, e shkundte nga baltërat dhe pastaj e varte në gozhdë. Kur flinte, mbulohej me të dhe e kishte në vend të jorganit.

Një natë kur shiu binte rrëke, krisi sherri. Qaniu, një shok i kompanisë do të dilte roje, po s'kishte kapotë. Nurçja, që e dinte mirë ç'është shiu, i tha:

— Merre kapotën time!

— Jo, nuk e marr, — i tha Qaniu.

— Merre të them, — përsëriti Nurçja.

— Të thashë që nuk e marr. Ti ke nevojë për vete.

— S'ka gjë, merre, unë nuk kam lindur me kapotë.

— Unë nuk e marr...

Nurçja ja hodhi përsipër.

Qaniu, e mori dhe e flaku tutje:

— Mos u lodh kot, nuk e marr.

Nga zhurma u ngritën dhe partizanët që flinin në të njëjtën bazë. U zgjua dhe Teli, djali i vogël i zotit të shtëpisë, të cilin sa herë vinin partizanët, e mernte gjumi aty bashkë me ta.

— Ç'është kjo zhurmë kështu? — pyeti përgjumësh njëri nga partizanët.

— Unë i them merre kapotën, ai s'e merr, — gjegji Nurçja.

— Nuk e marr e nuk e marr, — ja priti Qaniu.

— Ama për këtë na zgjuat nga gjumi, — tha partizani dhe ktheu kurrizin për të vazhduar serinë e dytë të gjumit.

Nurçja me Qaniu u hëngrën një copë herë, po përsëri nuk binin që nuk binin në ujdi. Qaniu, i cili kësaj radhe mbante kapotën në dorë, kur pa se Teli, që flinte aty pranë, ishte mbuluar me një copë batanie të vjetër, ja hodhi përsipër. Nurçes i erdhi mirë dhe, pas kësaj zgjidhjeje plotësisht të pranueshme, u kumbis dhe e zuri gjumi.

Kaluan ditë dhe kapota e Nurçes mbahej gjithmonë e re. Përsëri ai kujdes i ditëve të para, përsëri ato shërbime...

Një natë përsëri krisi sherri. Në bazën ku flinte dhe mitralieri ynë, u sëmur një partizan. Nga ethet filloi të dridhej si purtekë. Nurçja u mendua një copë herë e i tha:

— Na, merre kapotën time dhe mbulohu!

— Po ti ç'do të mbash për vete, — i tha ai.

— I jap unë kapotën time, — u hodh Asllani, një partizan faqekuq dhe me një palë mustaqe të zeza pisë.

— Kapota ime është më e re, — ja priti Nurçja

— Dhe kjo imja nuk është e keqe.

— Na, merre këtë, të them!

— Këtë, këtë...

— Tuaf njeri, merre të them!..

Partizanët, që rrinin këmbëkryq pranë zjarrit, u futën dhe ata në valle. Dikush thosh që i sëmuri duhej të mbulohej me kapotën e Nurçes, se ajo ishte si qyrk që të shëron, disa të tjerë thonin që të mbulohej me atë të Asllanit.

Më në fund e vunë në short dhe i sëmuri u mbulua me kapotën e Asllanit.

Të nesërmen puna e kapotës mori dhenë. Partizanët, që e njihnin mirë historinë e kapotës së Nurçes, thurnin lloj-lloj shakarash dhe ato shkuan aq larg, sa atij ja ngjitën nofkën kapota.

Herë pas here e rast pas rasti, në mes Nurçes dhe partizanëve, kriste sherri dhe kurdoherë molla e sherrit ishte kapota.

Para disa ditësh isha me shërbim në qytetin N. Rastësisht takova Nurçen. U futëm në një kafene dhe pimë nga një kafe. Bashkë me Nurçen kujtuam jetën partizane, vuajtjet, sakrificat dhe... kapotën. Jashtë binte shi i hollë sa mezi ndihej dhe bënte ftohtë. Pas pak u ngritëm.

— S'ke çadëre? — më pyeti Nurçja.

— E kam harruar në hotel, — i thashë.

— Merre timen.

— Po ti?

— S'ka gjë, mua s'ka ç'më bën më shiu.

— As mua s'ka ç'më bën.

— Merre çadëren, të them!

— Jo, nuk e marr...

U hëngrëm një copë herë te dera e kafenesë.

M'u kujtuam zënkat e atëhershme për punë të kapotës dhe i thashë:

— Më duket se po bën si atëherë me kapotën.


— Unë nga kjo anë nuk kam ndryshuar fare, jam po ai Nurçe që njeh ti.

Vërtet nga kjo anë Nurçja s'kishte ndryshuar fare, dhe s'kish pse të ndryshonte.

NË BILARDO

Disave, në mes tyre edhe mua më është bërë zakon që aty nga ora 10 e mëngjezit të vete në klub për të pirë kafe. Një ditë shkua bashkë me mjekun e qytetit tonë dhe zumë një tavolinë. Kur mbaruam kafënë, i propozova mjekut që të shihnim ndonjë lojë bilardoje në dhomën tjetër, atje përtej, ku luanin të rinjtë. Ai pranoi dhe ne duke çarë tymin e dendur të duhanit u futëm në sallën e bilardos. Në njërën nga bilardot luanin dy të rinj. Qëndruam një copë herë më këmbë duke parë.

Qysh në fillim më ra në sy se të dy kundërshtarët bënë një lojë të shkathët, të sigurtë dhe plot të papritura. Stekat që fërkoheshin herë pas here me tebeshir shkisin si suvajka, por bilat disa herë tregoheshin kokëforta dhe tekanjoze. Ato sillëshin si të hasdisura nëpër kadifenë bojë jeshile dhe në shenjë hakmarrjeje jo vetëm që nuk futeshin nëpër vrima, po bënë edhe «natë». Kjo i inatoste pa masë lojtarët, po ata si njerëz të ngeshëm



dhe me përvojë nuk e humbisnin durimin, pasi e dinin se me të keq nuk i dilej. Atëherë me gjakftohtësi dhe duke përdorur të gjitha aftësitë e tyre i goditnin mu në kokë, dhe atëherë bilat s'dinin se në ç'vimë të futeshin më parë. Zhdukeshin një nga një dhe me panik të madh. Më në fund ja dhe bila e fundit u fut me këmbët e saj në një nga vrimat më të afërta të fushës së bilardos. Loja me kaq mori fund.

— Mos u gëzo, — i tha ai që humbi, fituesit, — kemi dhe finalen.

— Me gjithë qejf, — ja priti fituesi. Unë sot kam planifikuar të luaj tërë ditën me shpenzimet e tua.

— Po kësaj ç'i thua, — i shkela syrin mjekut, dhe pastaj ju drejtova fituesit: — Nuk më thua, pse nuk luani me të djathtën, apo jeni mëngjërosh?

— Jo, — ma priti ai, — të djathtën e kam vrarë në punë. Jam me raport mjeku.

Unë pashë mjekun që u skuq si furnellë, kur e pa me inat pacientin e tij dhe kur shfryu nëpër dhëmbë «ta ndreq unë raportin ty».

U larguam, pa folur me shoshoqin.

MAGAZINIERJA

Si kudo, edhe në kryesinë e kooperativës bujqësore «Sulmi» problemi i ngritjes së gruas në përgjegjësi u kap seriozisht. Pasi e diskutuan teorisht dhe praktikisht problemin, vendosën, më në fund, që në vendin e magazinierit të caktojnë një grua, e cila, sipas karakteristikave që u paraqitën, i kishte gjithë kushtet.

Të nesërmen, Sania (kështu e quanin gruan që do të zëvendësonte magazinierin) la punën e arës dhe u paraqit në magazinë për të marrë dorëzimet.

- Erdhe? — e pyeti magazinieri.
- Erdha, — ju përgjegj ajo.
- Me këmbë të mbarë! La e më la!
- Të falemnderit!

— Ja, pra, kjo është magazina, — e mori fjalën sërish magazinieri. — Këtu ke arka, thasë, peshore, andej ke bereqet, zarzavate, bidonë me qumësht, pleh kimik, palldeme, patkonj, gozhdë, dërrasa, plamas, rrogozë... Këtu mbi tavolinë, siç

e sheh, ka regjistra, libra, blloqe për hyrje-dalje; me një fjalë, këtu janë regjistruar tërë këto që të sheh syri brenda këtyre katër mureve. S'janë pak, është goxha pasuri...

— Do të mësojmë dalëngadalë, — tha Sanija.

— S'do mend, — ja ktheu magazinieri. — Edhe unë nuk i mësova të tëra menjëherë. Ju, — vazhdoi ai, — pa tjetër kini nevojë për një stazh, të paktën një ose dy muaj, derisa të mësoheni ndryshe, ja ku po jua them qysh tani, hem veten do ta merrni më qafë, hem kooperativën do ta nxirrni me këpuçë të kuqe.

Sanija ngriti supet dhe nuk foli. Ndërkohë jashtë u ndienë rrotat e një karroce dhe zëri i dikujt që u çirrej kuajve. Magazinieri doli jashtë dhe hapi të dy kanatat e dyerve të magazinës.

— Ku ta shkarkojmë këtë misër? — pyeti karrocieri.

— Atje në qoshe, — ja priti magazinieri dhe i tregoi me gisht vendin se ku do të shkarkohej. Pastaj ju drejtua Sanijes: — Hë, ç'më rri duarkryq! Veri shpatullat dhe shkarkoje, se nuk pret burri i botës.

— Unë do ta shkarkoj? — pyeti si me drojtje Sania.

— Rri ti, se e shkarkojmë ne, ndërhyri karrocieri.

— Të lutem! Pse, s'di ta ndihmoj unë? Por jo, duhet të mësohet vetë, se nesër pasnesër ajo do të jetë zot këtu në magazinë. — Pastaj ju ngërdhesh magazinieres: — Pse, kollaj të duket ty puna e magazinierit? Hamallëke ke këtu... —

Kështu i do mushka drutë, — i tha mënjanë karrocierit.


Sanija kërrusi shpinën dhe i shkarkoi thasët një nga një, ndërsa të dy burrat shkëmbyen duhan dhe bënë muhabet në një kënd, ku bënte pak fresk.

Sapo mbaroi së shkarkuari, ja behu kamioni i kooperativës. Magazinieri përcolli karrocierin dhe i doli përpara shoferit:

— Ç'ke kështu? — e pyeti ai shoferin, kur e pa që i kishin hipur kacabunjtë.

— Lermë rehat, për kokën tënde. T'i ngarkojmë shpejt bidonat se na u bë vonë, — foli me inat shoferi dhe u nis të ngarkojë bidonët.

Magazinieri ngriti dorën lart, siç bëjnë ata të policisë rrugore kur duan të ndalin ndonjë maqinë që ka shkelur rregullat e qarkullimit dhe, pasi bëri



një rrotullim djathtas, i tundi kokën Sanijes. Ajo e kuptoi këtë lëvizje dhe filloi të ngarkojë bidonat mbi maqinë.

Shoferi e pa vëngër magazinierin, po ky i dha të kuptojë që të mos bëhej merak asaj ane. Pastaj, duke tundur kokën me hidhërim ngriti kapakun e maqinës për të kontrolluar një defekt, kurse magazinieri u suall rrotull maqinës, i mori erë si zagarët kur bien në gjurmët e lepurit dhe pastaj, duke harruar se do të grindej me shoferin, i ra borijes. Po sherri më i madh krisi atëherë, kur Sanija vonoi se s'gjente dot bllokun e fletë-daljeve.

— Ore, pse më çirresh mua! — i thosh magazinieri shoferit. — Sos jam unë magazinieri! Ja tek e ke shoqen...

Sanija ishte bërë prush dhe dridhej si purtekë nga inati. I vinte plasja, sepse pak më parë kish vënë re me sytë e saj mbi tavolinë bllokun e fletë-daljeve.

Shoferi iku duke mallëkuar.

— Ja ç'domethënë të jesh magazinier, të bësh punë dhe të hash të shara nga prapa, — i tha magazinieri Sanijes pasi maqina u zhduk në renë e pluhurit që la prapa. Ai desh të filozofonte rreth të papriturave të punës në magazinë, por nuk pati kohë, pasi, me t'u nisur maqina, erdhi një qerre. Edhe këtë, sipas porosisë së magazinierit, e shkakoi Sanija. Erdhën dhe të tjera karro e kafshë barre. E njëjta skenë: Sanija përkulte kurrizin dhe i shkarkonte ose ngarkonte ato, kurse magazinieri bënte muhabet dhe herë pas here vinte

në dukje meritat e shpatullave të magazinieres së re...

Kjo punë e lodhi dhe e raskapiti Sanijen, po nuk jepej. Sa herë që shpinte mezin nga lodhja, magazinieri i thosh: «Hajt, se do të mësohet kurrizi. Je akoma e re. Apo s'i ke shpatullat mashalla!... S'është kollaj të jesh magaziniere... Të del shpirti...» Dhe po nuk ta nxora shpirtin unë, — mërmëriste nëpër dhëmbë magazinieri, — mos më thëncin në emër»...

Pas disa ditësh Sanijes i erdhi në majë të hundës dhe shkoi në kryesi të kooperativës. Ju ankua kryetarit dhe ju lut që ta dërgonte përsëri në arë me shoqet e saj, pasi kjo punë ja kishte bërë shpirtin derr.

Kur mësoi si qëndronte puna, kryetarit i hipi gjaku në kokë dhe u nxeh me vete që nuk kishte kontrolluar zbatimin e përpiktë të vendimit mbi zëvendësimin e punës së burrit me atë të gruas. Pastaj urdhëroi të thirrej menjëherë magazinieri:

— Bah, si është e mundur! — shfryu pas pak kryetari. — Ai është burrë i mirë.

— Ndoshta, po punët qëndrojnë ashtu siç ju thashë, — tha Sanija.

Ajo heshti dhe, për një çast, dëgjonte kryetarin që shfrynte poshtë e lart nëpër zyrë.

Kryetarin filloi ta hajë dyshimi se mos me të vërtetë magazinieri ishte sjellë kështu për ta mër-zitur dhe për ta trembur atë, apo me këto që thosh ajo donte të mbulonte paaftësinë e saj.

Ndërkohë erdhi magazinieri, të cilit ju hakërrua sapa shkeli në zyrë.

Për një çast magazinieri e humbi si Xhaferri

simiten, por pastaj si e mori veten dhe e kuptoi ku rrihte çekani, ju përgjegj qetë-qetë:

— Më vjen keq, shoku kryetar. Nuk e kam ditur se kjo shoqja qenka kaq karrieriste. Unë tërë barrën e magazinës kësaj ja kam lënë dhe, sa për vete s'më kanë mbetur veçse hapsat e kashtës...

— Të thashë, — i tha kryetari magazinieres së re, — se nuk është bërë me qëllim. Të paktën s'kemi prova për të vërtetuar të kundërtën...

Ditët e fundit mora vesh se kryetari dhe magazinieri i kooperativës të cilët hanin në një çanak, kishin rënë nga... fiku.

KUSH ËSHTË FAJTORI?

Një herë një qytetar shkoi në një dyqan dhe bleu një palë këpucë. I mbathi aty për aty dhe, para se të shkonte në shtëpi e pa të udhës t'i binte një herë rrotull pazarit. Këpucët ishin të bukura dhe bënë kërr, kërr, kërr kur shkelnin përdhe. Kjo u tërhoqte vëmendjen e qytetarëve dhe atij i dukej sikur i rritej vetja. Në mbrëmje kur i hoqi nga këmbët pa se njëra prej tyre ishte shqepur. I erdhi inat sa s'ka më. Mallëkoi çfarë i doli përpara.

Të nesërmen shkoi në dyqan dhe ju ankua shitëses për këpucët që bleu një ditë më parë.


— Kini të drejtë, — i tha shitësja, — po ne të tregëtisë vetëm shesim, këto i prodhon fabrika e këpucëve.

Qytetari e falenderoi dhe shkoi në fabrikën e këpucëve për t'u ankuar :

— Kështu e kështu më ndodhi me këpucët, — iu ankua ai atyre të drejtorisë.

— Ju janë shqepur lart apo poshtë?

— Nga poshtë lart, në mënyrë krejtësisht demokratike.



— Kini të drejtë, po ne me këtë lëkurë na furnizon fabrika e lëkurëve.

Me që fabrika e lëkurëve nuk ishte larg, qytetari shkoi deri atje :

— Kështu e kështu më ka ndodhur, — u thotë ai atyre të fabrikës së lëkurës.

— Çfarë lëkure janë këpucët, bagëtie apo?..

— Bagëtie e bujqësie... .

— Kini plotësisht të drejtë, — i thanë ata, po ne ç'të bëjmë? Këtë lëkurë na dërgojnë ata të grumbullimit.

Qytetari i papërtueshëm nuk e zgjat dhe shkon drejt e në zyrat e grumbullimit dhe u tregon atyre se si është puna.

— Ç'ne neve me këpucët tuaja, ne jemi grumbullim. Fundi ne u japim atyre të fabrikës së lëkurës atë çka na japin thertoret, — i thanë ata.

Qytetari i falenderon dhe shkon në thertoren më të afërt. Takohet me kryekasapin dhe i tregon se si qëndron puna:

— Çfarë sqarimesh kërkoni prej meje. A jeni dhe ju kasap?

— Si urdhëron!

— Dhe nuk keni dorëzuar ndonjëherë lëkura jashtë standartit?

— Po, kam dorëzuar.

— Atëherë ç'kërkoni?

Qytetari u largua i skuqur nga turpi dhe tha me vete: «E pësova si cjapi tek kasapi. Ja si ndodh kur të duken pa rëndësi shkeljet e vogla».

MJEKU I ROJËS

— Infermierin e rojës e kish zënë gjumi aq, sa, kur u fut mjeku në dhomën e vogël të urgjencave, nuk e ndjeu fare.

Mjeku në fillim e qortoi, por pastaj, si u ul tensioni, filloi t'i tregojë atij anekdota dhe qyfyre, të cilat e bënë infermierin të qeshte e gjumi t'i fluturonte qindra kilometra larg.

Atë çast, kur muhabeti kishte marrë rrugë të mbarë, u hap dera dhe brenda u fut një djalë i ri, të cilin e kishte lagur shiu e e kishte bërë peshk.

— Urdhëro, çun! — i tha mjeku dhe u ngrit e i dha për të ndenjtur një nga ato stolat e hekurt që gjenden nëpër ambulanca.

Djali mbeti për disa kohë më këmbë pa folur dhe kur u ngop me frymë tha:

— Kam babanë sëmurë.

— Çfarë ka? — pyeti mjeku dhe pastaj, pa marrë përgjegjen, rrëmbeu çantën e veglave, veshi mushamanë, doli në oborr dhe bashkë me djalin hipi në autoambulancën e urgjencave.

Të sëmurin e gjeti në kllapi. I vuri dorën në ballë, i preku pulsën dhe pastaj pyeti ata të familjes për të zbuluar anamnezën e të sëmurit. Pas pak i sëmuri u përmend dhe mjeku i mati temperaturën, pulsën dhe tensionin. Kishte zjarrllëk. Përvëlonte. Ata të shtëpisë nuk guxonin të thyenin heshtjen, por gjurmonin mimikën e mjekut dhe prej këtej e mërrnin me mend se si qëndronte puna. Si mbaroi, dha recetën, disa porosi dhe iku duke u thënë atyre të shtëpisë: «S'ka gjë, s'ka gjë», fjalë të cilat mjekët zakonisht i lëshojnë në vend të lamtumirës.

Të nesërmen, pasi mbaroi punën e tij të zakonshme, mjeku u kthye përsëri tek i sëmuri dhe pa se ilaçet po bënin efektin e tyre fillestar. Dha porosi të tjera dhe u largua duke përsëritur: «s'ka gjë, s'ka gjë». . . Vazhdoi të kthehej përditë atje për të marrë vesh shëndetin e të sëmurit. Pas një jave, kur i sëmuri filloi ta ndjejë veten më mirë, mjeku e pyeti:

— Si e ndjen veten?

— Më mirë, doktor. Ju falemnderit. S'di si t'jua shpërblej kujdesin tuaj.

— Përkundrazi, — ja ktheu mjeku, — unë s'kam si t'jua shpërblej. Ju më kini hapur sytë, më kini shëruar. . .

I sëmuri rregulloi jastëkun që po i shkiste, mbuloi me batanie supin e zbuluar dhe tha:

— Unë ju kam shëruar?.. Më falni, po unë nuk kam qenë kurrë mjek.

— Ndoshta nuk mbani mend. Unë kam qenë ndër pacientët tuaj të parë. Ju kini shëruar dhjetë-

ra e ndoshta qindra si unë, që sot janë mjekë, inxhinierë, oficerë dhe kuadro të ndryshme.

— Gaboheni doktor, e kini jangllësht.

Kësaj radhe lëvizi dhe u tund nga vendi më me energji, sikur të përmendej nga një ëndërr e çuditshme.

— Mos më merrni për ndonjë tjetër, — përsëriti i sëmuri.

— A jini ju Skënderi, ose Tomorri, siç ju thërrisnin atëherë?

— Si urdhëron!

— A kini qenë ju komisar batalioni në Brigadën e... të Ushtrisë nacionalçlirimtare?

— Si urdhëron!

— A ju kujtohet një pionier trupvogël e tham me një palë rrobe shajaku e që ju atëherë e thërrisnit «kaçator»? A nuk ju bie ndër mend ai nxënësi juaj i vogël me të cilin harxhonit orë të tëra për t'i mësuar shkrim e këndim? E harruat porosinë që u jepnit atëherë pacientëve tuaj të shumtë? «Mëso, mësoni me durim, që të bëheni nësër doktorë, inxhinierë, agronomë... zotër të vendit tuaj. Ja, pra, ku jam unë i tëri ai ish-pionieri i reckosur, ai kryeneçi e harakati që ju e shëruat njëherë e përgjithmonë.

I sëmuri mbeti gojëhapur dhe s'dinte ç'të thoshte. Sytë dhe fytyra, që pak më parë ishin futur në galerinë e kujtimeve, tani ishin ngazëllyer dhe kishin marrë pamjen e atij nxënësi që kishte zbërthyer me sukses ekuacionin me një të panjohur.

BABALLARËT E KOMBIT

Edhe në të kaluarën bëheshin zgjedhje, bile zgjedhje nga më të zgjedhurat që ka parë e njohur historia.

Për të mos e zgjatur po ju tregoj një episod elektoral:

Ka qenë viti 1935-1936, nuk më kujtohet mirë. Lexuesit do të ma bëjnë hallall këtë mungesë saktësie. Atëherë bëhej fushata elektorale, për të zgjedhur kryepleq lagjesh, kryetarë bashkie dhe deputetë. Këta të fundit kishin një emër të veçantë «baballarë kombi». Se kush ishte autori i këtij epiteti onomatopeik nuk më kujtohet, po kjo s'ka rëndësi për tregimin tonë.

Asokohe lagjet e Tiranës ishin me shtëpi të ulta qelpiçi. E vetmja godinë me tulla ishte xhamia dhe shtëpitë e nëpunësve të lartë dhe tregëtarëve të pasur.

Duke qënë se xhamia ishte njëkohësisht edhe vakëf, votimet bëheshin aty. Nuk di sepse përveç kutisë së votimeve, që dukej si një arkivol i vendo-

sur në mes të xhamisë, kishin vënë edhe një dërrasë të zezë.

Procedura e votimit, nuk ishte gjë e lehtë, pasi 99⁰/₀ e votuesve ishin analfabetë. Analfabet natyrisht ishte dhe kryeplaku, edhe kandidati. Edhe ai që ishte autorizuar të përfaqësojë komisionin e votimeve kishte një shkrim të atillë, që vetëm pulat mund t'ja deshifronin.


Në mbrëmje, ndërsa komisioni po numëronte votat, ndodhi diçka e papritur që shkaktoi gjendje alarmi. U pa se në dërrasën e zezë ishte shkruar me shkumës të bardhë dhe me shkronja të mëdha kjo fjali: «GJYSMA E DEPUTETËVE JANË ANALFABETË». Këtë gjë e vuri re personi i autorizuar për përfaqësimin e votuesve, i vetmi, që, siç thamë më lart, dinte të shkruante e të lexonte. Ky njoftoi kryeplakun dhe kryeplaku poskomandantin e xhandarmërisë. Hetimet u zhvilluan me shpejtësi të rrufeshme dhe guximtari u zbulua. Ai ishte një djalosh që punonte si radhitës në shtypëshkronjën «Gutenberg», i vetmi votues që e kishte mbushur fletën e votimit me dorën e tij.

S'do mend që atë e arrestuan në vend dhe e sollën të shoqëruar në qendër të votimit, domethënë në xhami. Ai kishte bërë një faj shumë të rëndë, sepse kishte ofenduar «baballarët e kombit», ndaj duhej ta lante në atë tempull të perëndisë.

— Qora jemi ne që të na hedhësh hi syve? — ju kërcënua poskomandanti

— Syleshë na pandeh ti? — ju hakërrua kryeplaku.

— Ta ndreq unë samarin! — i tha poskomandanti. — Por, përpara se të fillojmë procesin për



ndjekjen penale për fyerjen kundër «baballarëve të kombit», që do të thotë kundër vetë naltmadhërisë, fshije me dorën tënde atë sharje të mallëkuar dhe dua që ta lëpishë në sytë tanë atë që ke pështyrë.

Punëtori i zgjuar e sy patrembur ju afrua dërrasës së zezë me gjakftohtësi dhe në vënd të fshirses kapi shkumësin dhe me dorën e tij të sigurtë i shtoi fjalisë fjalëzën « nuk ».

Poskomandanti duke i ndarë fjalët në rrokje lexoi me zë të lartë:

— GJYSMA E DEPUTETËVE NUK JANË ANALFABETË.

Kryeplaku e pyeti:

— Përse nuk e fshiu?

— Njësoj është, — e qetësoi poskomandanti,
— shtoi një fjalë që e mohon të parën.

— Ç'do me thënë e mohon?

— I bie hasha.

— Edepsëzi. Domethënë e lëpiu në sytë tanë
atë që pat pështyrë

— Besbeli, — tha poskomandanti, — s'kishte
rrugë tjetër. Ne jemi më të zgjuar se ai.

LEJA E QARKULLIMIT

Ishte pranverë e vitit 1942. Nëpër rrugët e Tiranës qarkullonin me pushkë krahëve milicët. Ata ruanin rendin. Në mbrëmje, me të perënduar dielli, fillonte «koprifokoja», që do të thoshte të mbylleshe brenda në shtëpi e të dilje bashkë me lindjen e diellit.

Natën dëgjoje zhurma që ishin bërë monotone për qytetarët e Tiranës: sirena alarmi, uturimë aeroplanësh në qiellin e nxirë dhe hapa në kalldrëmet e errëta.

Një pasdreke R. kishte vajtur në shtëpinë e një shokut të tij. Ai ishte ilegal dhe u ruhej gjurmimeve të policisë. R. bisedoi një copë herë për luftën me shokun e tij, sepse lufta aso kohe ishte tema e ditës për legalët dhe ilegalët, për të gjithë. Biseda i pat rrëmbyer, prandaj R. nuk e vuri re se muzgu kishte rënë me kohë. U kujtua për «kopri-fuokon» kur u ngrit shoku i tij të ndezë llambën me vajguri.

— Po tani si t'ja bëj? — i tha ai.

— Aq më mirë, qëndro këtu. Je si në shtëpinë tënde.

— Nuk qëndroj dot, — nguli këmbë R., sepse shokët më presin, do të bëhen merak, do të kujtojnë se më kanë arrestuar.

— Si do të bësh të dalësh?

— Do të bëj si të bëj.

— Do të të arrestojnë. Ti nuk ke leje-qarkullimi.

— Leje qarkullimi nuk kam, po s'kam edhe ndonjë parandjenjë të keqe.

I uroi natën e mirë shokut dhe doli.

Qyteti ishte krejt i zbrazur, rrugët krejt të shkreta. Një hije e zezë rëndonte mbi Tiranë.

R. ecte duke mbajtur cingaren nderur dhe priste të dëgjonte në çdo hap britmën e çjerrë: ndal! Dhe e dëgjoi pikërisht në kthesën e rrugës «Bar-dhyl». Ai qëndroi në vend. Ju afruan me hap të rëndë dy milicë të armatosur me pushkë e me mustaqe të gjata.

— Duart lart!

R. u bind. Ngriti duart.

— Ku shkon? — e pyeti njëri.


— Në shtëpi, zoti kapter, — u përgjegj R. ndonse ai kishte vetëm një shirit teatri në krah.

— A ke letër njoftimi?

R. uli njëren dorë, e futi në xhep dhe i zgjati një letër-njoftimi të falsifikuar.

Milici e kaloi vështrimin disa herë nga fotografia e dokumentit tek fizionomia e R., pastaj tha:

— Po leje-qarkullimi a ke?



Këtu ngeci sharra në gozhdë. Leje qarkullimi R. nuk kishte, po për t'u dhënë përshtypjen se ishte në rregull, uli përsëri njëren dorë dhe nisi të gërmojë nëpër xhepa. Gishtërinjtë i kapën një faturë të vjetër, me të cilën kishte paguar dikur dritat në shoqërinë SITA. Për fat fatura kishte edhe dy pulla monopoli. Ja dha. Milici bëri sikur po lexonte përmbajtjen, megjithëse faturën e kishte me kokëposhtë. Pyeti:

— A thue leje është kjo?

Ndërhyri milici tjetër:

— Po, zotni tetar, paska dhe pulla.

Tetari mori një pozë të rëndë, e lejoi të ulte duart dhe të vijonte rrugën.

— Ju falemnderit, — i tha R. i qetësuar. — Për fat të mirë u ndesha me ju që qenkeni njerëz të «mësuar». Por dyshoj mos takoj më tej me ndonjë patrullë tjetër që s'di shkrim e lexim e mund të na ndodhë ndonjë ngatërresë kot së koti. A thua do të bënit një mundim të më përcillnit?

Ata patën mirësinë ta përcillnin R., gjer atje ku e kishte punën.

PASQYRA E LËNËS

Tërkuza	3
Analfabetët	8
Djalin s'e bëj marangoz	14
Miza	19
Brahushi, Bilushi dhe lopa	23
Si ma hodhën shoferët	30
Zjarri	34
Sëmundje trashëguese	37
Arësyetim arithmetik	43
Si drejtohet gozhda	46
Përmbytja	50
Tipa të psonisur	53
Miu	57
Ariu	62
Kursimtari	67
Rrobalarësja	72
Qeni dhe macja	76
Kapota	81
Në bilardo	85
Magazinerja	88
Kush është fajtori	94
Mjeku i rojës	97
Baballarët e kombit	100
Leja e qarkullimit	104


 53317